



**FITO**  
me

**INTEGRITET**

**PËRFITIMI I BESIMIT TË  
QYTETARËVE NË  
PARTITË POLITIKE**

**Fito me integritet: Përfitimi i besimit të qytetarëve në partitë politike**

Nga NDI Instituti nacional demokratik

Copyright © 2021 The National Democratic Institute (NDI)

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Pjesë të këtij punimi mund të riprodhohen dhe / ose të përkthehen për qëllime jokomerciale me kusht që NDI të njihet si burimi i materialit dhe t'i dërgohet kopje nga çdo përkthim.

# **FITO** **me** **INTEGRITET**

**PËRFITIMI I BESIMIT TË QYTETARËVE  
NË PARTITË POLITIKE**

Udhëheqës teknik

**Sarah Travis, NDI Programet për partitë politike**

## Për NDI Instituti nacional demokratik

Instituti nacional demokratik (NDI) është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare që i përgjigjet aspiratave të njerëzve anembanë botës për të jetuar në shoqëri demokratike që njohin dhe promovojnë të drejtat themelore të njeriut. Që nga themelimi i tij në vitin 1983, NDI dhe partnerët e tij lokalë kanë punuar të mbështesin dhe përforcojnë institucionet demokratike dhe praktikant duke përforcuar partitë politike, organizatat qytetare dhe parlamentet, duke ruajtur zgjedhjet dhe promovuar pjesëmarrjen qytetare, qeveri të hapur dhe llogaridhënëse. Me personel dhe praktikantë vullnetarë politik nga më shumë se 100 kombe, NDI bashkon individë dhe grupe për të shkëmbyer ide, njohuri, përvoja dhe ekspertizë. Partnerët ekspozohen gjerësisht ndaj praktikave më të mira në zhvillimin demokratik ndërkombëtar që mund të përshtaten me nevojat e vendeve të tyre. Qasja shumëkombëshe e NDI forcon mesazhin se pasi nuk ekziston një model i vetëm demokratik, disa parime themelore janë të përbashkëta për të gjitha demokracitë. Puna e Institutit mbështet parimet e përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu promovon zhvillimin e kanaleve të institucionalizuara të komunikimit midis qytetarëve, institucioneve politike dhe zyrtarëve të zgjedhur dhe përforcon aftësinë e tyre për të përmirësuar cilësinë e jetesës për të gjithë qytetarët: Për më shumë informata mbi NDI, ju lusim të vizitoni [www.ndi.org](http://www.ndi.org).

## Mirënjohje

Sarah Travis, menaxhere e programit për programe të partive politike në NDI, ka shërbyer si menaxhere dhe udhëheqëse teknike në metodologjinë e këtij projekti me mbështetjen e Birgitta Ohlsson, Ivan Doherty, Sef Ashiagbor dhe Kellor Yde të NDI. NDI falënderon Françeska Binda të Binda Consulting International për hartimin e këtij botimi, si dhe Erin Methjuz dhe Shenon Okonell për hedhjen e themelimit të këtij punimi përmes hulumtimeve. Stafi i mëposhtëm i NDI ka dhënë kontribute të vlefshme në pilotin fillestar dhe zbatimin e projektit: Alehandro García, Aleksandra Krsteska, Andrés Osorio and Lidija Zafirovska. Mirënjohje plotësuese i drejtohet edhe Andrea Fernández, Diego González, Robert Skot Hejzlet dhe Francisko Herrero për kontributet e tyre. Mirënjohje e veçantë shkon për Ana Radiçeviçin dhe për ekipin e programit rajonal për integritet të partive politike të NDI për frymëzimin e kësaj pune me partitë në të gjithë Institutin. Përveç kësaj stafi i NDI-së në vijim ka shqyrtuar draftet e ndryshme të këtij publikimi duke ofruar rekomandime për përmirësime gjatë një tryeze të rrumbullakët në prill 2020: Artan Alijaj, Aron Azelton, Kristian Bruner, Trejsi Kuk, Josif Ezekilov, Robert Skot Hejzlet, Karolina Habard, Ana Kovaçeviç-Kadoviç, Budimir Miliç, Sofia Mestrup, Nikolas Montano, Nadezhda Muzikina, Ketii Maxh, Komfort Pingjilani, Dana Radojeviç, Raisa Tatad-Hazell dhe Lindsii Uorkman. Më në fund, NDI u shpreh mirënjohje liderëve politik dhe aktivistëve qytetar në Kolumbi dhe Maqedoninë e Veriut që ranë dakord të marrin pjesë në pilotin e këtij projekti; perspektivat e tyre të paçmuara ndihmuan për ta bërë këtë projekt të mundshëm.

## PARATHËNIE

Për dekada të tëra, në pjesën më të madhe të botës, përfshirja në politikë ka qenë sinonim i mbështetjes, anëtarësimit ose promovimit të një partie politike. Ende partitë politike janë akoma pjesë e formimit të shtyllës kurrizore të demokracisë dhe duhet të vazhdojnë të luajnë rol kyç në qeverisjen demokratike duke përfaqësuar qytetarët dhe duke përmbledhur shqetësimet e tyre në politikë, ndërsa me anë të vetingut (verifikimit), të përzgjedhin dhe ndikojnë tek liderët politikë. Sidoqoftë, korrupsioni, kapja e shtetit, popullizmi dhe organizatat e errëta partiake minojnë besimin e popullit ndaj partive në të gjithë botën, duke nxitur paqëndrueshmëri politike. Qytetarët gjithnjë e më shumë i perceptojnë partitë si të drejtuar nga elita dhe jo përfaqësues të qytetarisë më të gjerë; jo të gatshëm për të përfshirë dhe fuqizuar gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara historikisht; të pa përkushtuar për transparencë dhe përgjegjshmëri; dhe përgjithësisht jo të besueshëm.

Për t'u zhvilluar, përparuar dhe mbijetuar në botë sot, partive u duhen mjete, plane dhe modele më të mira për t'u bërë më të përqendruar në qytetarët, gjithëpërfshirës, etik, transparent dhe të përgjegjshëm. Por para së gjithash, ata duhet të jenë vërtet të përkushtuar ndaj vlerave të tyre thelbësore dhe të krijojnë një kulturë të integritetit, hapjes dhe ndershmërisë, sepse siç thotë një fjalë e urtë, "kultura han strategjinë për mëngjes". Ne në NDI shpresojmë se kjo kornizë për vlerësim të integritetit të partive politike mund të jetë një instrument i dobishëm në këtë kuti me vegla për ndryshim.



Birgitta Ohlsson

Drejtoresh e Programeve të partive politike, Instituti nacional demokratik  
Ministres e mëparshme e Suedisë dhe deputete.



# PËRMBAJTJA

## **PJESA (1): ÇFARË ËSHTË INTEGRITETI I PARTISË POLITIKE DHE PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM** **13**

Çfarë është Integriteti i partisë politike?	13
Përse është i rëndësishëm integriteti i partisë politike?	16

## **PJESA (2): SI TË PËRDORËT KORNIZA PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT TË PARTIVE POLITIKE** **17**

Përfitimet nga realizimi i një Vlerësimi për integritet të partisë politike	17
Si të realizohet vlerësimi për integritet të partive politike	18
Krijimi i një ekipi për vlerësim brenda partisë	18
Përdorimi i një lehtësuesi të brendshëm	18
Përdorimi i një lehtësuesi të jashtëm	19
Shkalla e integritetit dhe shënimi i pikëve	21

## **PJESA (3): KORNIZA PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT TË PARTIVE POLITIKE** **23**

<b>1. Struktura organizative dhe proceset e brendshme</b>	<b>23</b>
Strukturat organizative dhe vendimmarja	23
Përmirësimi i strukturave partiake në Marok	24
Përzgjedhja e anëtarësisë, kryesisë dhe personelit	24
Proceset e monitorimit, pajtueshmërisë dhe ankesave	25
<b>Pyetjet për vlerësim të integritetit</b>	<b>26</b>

<b>2. Kultura organizative</b>	<b>29</b>
Standardet mbizotëruese të sjelljes së partive politike	30
Reagimi ndaj sjelljes së pahijshme	30
Sjellja e udhëheqësisë	30
Përmirësimi i kulturës organizative në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë	31
<b>Pyetjet për vlerësim të integritetit</b>	<b>32</b>

<b>3. Vetingu i kandidatëve dhe përzgjedhja</b>	<b>37</b>
Vetingu i kandidatëve	37
Nënshtrimi verifikim të kandidatëve në El Salvador dhe Kosta Rika	38
Përzgjedhja e kandidatëve	39
Kostoja e të qënimit kandidat	40
<b>Pyetjet për vlerësim të integritetit</b>	<b>41</b>

<b>4. Diversiteti, barazia dhe përfshirja e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar</b>	<b>44</b>
Barazia gjinore	44
Promovimi i përfshirjes gjinore në Afrikën e Jugut	45
Diversiteti, barazia dhe përfshirja	46
<b>Pyetjet për vlerësim të integritetit</b>	<b>47</b>
<b>5. Mbledhja e fondeve dhe menaxhimi financiar</b>	<b>51</b>
Standardet dhe kufizimet lidhur me fondet dhe donatorët	52
Menaxhimi i brendshëm financiar dhe mbajtja e të dhënave	52
Shpalosje e donacioneve dhe donatorëve	52
Transparenca	53
Zbulimi financiar dhe transparenca në Indi dhe në Spanjë	53
Blerja e votës dhe përdorimi i stimujve material për votuesit	54
<b>Pyetjet për vlerësim të integritetit</b>	<b>55</b>
<b>PJESA (4): UDHËZIM SE SI TË ZBATOHEN GJETJET NGA VLERËSIMI I INTEGRITETIT</b>	<b>59</b>
Fillimi i bisedës me udhëheqësit e partisë	60
Prioritizimi i reformave të integritetit	61
Të filluarit në udhëtimin drejt reformës së integritetit	62
Vendosja e qëllimeve të integritetit	62
Identifikimi i aleatëve të integritetit	64
Hartimi i fuqisë	66
Përcaktimi i momentit më të mirë për zbatimin e reformave të integritetit	66
Komunikimi i progresit drejt integritetit te publiku	67
<b>PJESA (5): UDHËZIM SE SI TË MONITOROHET DHE VLERËSOHET PËRPARIMI DREJT REFORMËS SË INTEGRITETIT</b>	<b>71</b>
Teknikat e monitorimit dhe vlerësimit	72
Si të monitorohet dhe të vlerësohet progresi	73
Interpretimi i vlerësimit në veprim	75
<b>SHTOJCA 1: UDHËZIME PËR SHOQËRINË CIVILE DHE MEDIAT</b>	<b>81</b>
Avokimi i shoqërisë civile në Meksikë	82
Monitorimi i shoqërisë civile në Ugandë	83
Monitorimi i mediave në Kosta Rikë	84
Çështjet që duhet të konsiderohen për përmirësimin e integritetit të partive politike	84
Mbështetja e sjelljes etike të partive politike	88



## FLETËT E PUNËS

Fleta e punës 1: Përcaktimi i qëllimit të integritetit të partisë	76
Fleta e punës 2: Identifikimi i aleatëve të integritetit	77
Fleta e punës 3: Hartëzimi i fuqisë për reformën e integritetit	78
Fleta e punës 4: Vlerësimi i mbledhjes së të dhënave	79
Fleta e punës 5: Plani i zbatimit dhe vlerësimi të integritetit	80

## STUDIME TË RASTEVE

Përmirësimi i strukturave partiake në Marok	24
Verifikimi i kandidatëve në El Salvador dhe Kosta Rika	38
Promovimi i përfshirjes gjinore në Afrikën e Jugut	45
Zbulimi financiar dhe transparenca në Indi dhe në Spanjë	53
Avokimi i shoqërisë civile në Meksikë	82
Monitorimi i shoqërisë civile në Ugandë	83
Monitorimi i mediave në Kosta Rika	84

## PËRKUFIZIMI I TERMAVE KRYESORE

<b>Bullizëm, ngacmim dhe diskriminim</b>	Bullizmi është një sjellje e padëshiruar që ka për qëllim që t'i bëjë dëm (gojarisht dhe/ose emocionalisht) dikujt që ndjehet i pafuqishëm për tu përgjigjur. Ngacmimi është një sjellje e padëshiruar që ka për qëllim të bëjë që dikush të ndjehet i frikësuar ose i poshtëruar. Diskriminimi është trajtimi i pabarabartë i dikujt ose i një grupi bazuar në karakteristika të caktuara (p.sh., përkatësia etnike, feja, orientimi seksual, gjinia, mosha ose aftësia fizike). <sup>1</sup>
<b>Përzgjedhja e kandidatëve</b>	Mënyra në të cilën partitë politike zgjedhin individët për të garuar për kandidatë për zgjedhjet.
<b>Vetingu (verifikimi) i kandidatëve</b>	Procesi i kryerjes së kontrolleve plotësuese për të përcaktuar nëse individë të veçantë kualifikohen (sipas rregullave të partisë) për t'u zgjedhur si kandidatë.
<b>Diskriminimi</b>	Trajtimi i pabarabartë i dikujt ose një grupi bazuar në karakteristika të caktuara (p.sh., përkatësia etnike, feja, orientimi seksual, gjinia, mosha ose aftësia fizike). <sup>2</sup>
<b>Vlerësimi</b>	Një proces sistematik për të vlerësuar ndryshimet që rezultojnë nga reforma e integritetit.
<b>Diversiteti, barazia dhe përfshirja</b>	Praktika ose cilësia e përfshirjes dhe/ose sigurimit të mundësive dhe platformave kuptimplota, të barabarta për pushtet për bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar për të marrë pjesë në organet e brendshme të partisë dhe në vendimmarrje.
<b>Ngacmimi</b>	Sjellja e padëshiruar e cila ka për qëllim që ta bëjë dikë të ndjehet i frikësuar ose i poshtëruar. <sup>3</sup>
<b>Monitorimi</b>	Një proces sistematik për të mbledhur informata për të përcjellur përparimin drejt reformës së integritetit.
<b>Elitat partiake</b>	Individë brenda partisë që mbajnë një sasi joproporcionale të pushtetit dhe privilegjit për të kontrolluar sistemin.
<b>Integriteti i partisë politike</b>	Karakteristikë e partive politike që kanë në qendër qytetarët, duke përfshirë edhe grupet historikisht të marginalizuara, që inkurajojnë vendimmarrjen gjithëpërfshirëse dhe demonstrojnë sjellje etike, transparente dhe të përgjegjshme.
<b>Grupet historikisht të marginalizuara</b>	Grupe shoqërore që janë të përjashtuar nga sferat dominante sociale, ekonomike dhe/ose politike. Shembujt ndryshojnë në varësi të mjedisit dhe përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në njerëz të nënpërfaqësuar për shkak të racës, klasës shoqërore, fesë, përkatësisë etnike, moshës, gjinisë, orientimit seksual (lezbikë, homoseksual, biseksual, transgjinnor dhe interseksual—referuar edhe si LGBTQI+ për të përfshirë spektrin e gjinisë dhe seksualitetit) dhe aftësisë së kufizuar.
<b>Të rinjtë</b>	Secili nga mosha 18-35 vjeçare <sup>4</sup> , duke përfshirë edhe njerëz me identitete të ndërlydhura ( <i>intersecting</i> ) (gra, persona me aftësi të kufizuara, anëtarë të bashkësisë LGBTQI+, dhe pakica etnike, fetare dhe të dukshme).

# SI TË PËRDORIM FITIMIN ME INTEGRITET

Të fituarit me integritet ka për qëllim partitë politike me mendësi reforme dhe anëtarët e tyre. Synon që të ndihmojë partitë politike për të vetëvlerësuar procedurat dhe praktikrat e tyre të brendshme rreth çështjeve të integritetit (d.m.th., transparenca, llogaridhënia, vendimmarrja gjithëpërfshirëse), dhe identifikimin, priorizimin dhe planifikimin e reformës së integritetit brenda partive.

Përfito me integritet përfshin pjesët e mëposhtme:

- Çfarë është integriteti i partisë politike dhe pse është i rëndësishëm?
- Vlerësimi i Fito me integritet
- Udhëzime se si të zbatohen gjetjet e vlerësimit të integritetit
- Udhëzime se si të përcjellim progresin drejt reformave të integritetit
- Fletë pune për të ndihmuar partitë me zbatimin praktik të avancimit të reformës së integritetit
- Udhëzime për shoqërinë civile dhe mediat, të cilat janë partnerë kritikë për integritet më të gjerë politik

Fito me integritet mund të lexohet nga fillimi e deri në fund, ose partitë politike mund të lexojnë dhe të marrin pjesët e vlerësimit me më shumë interes. Në këtë udhëzues, partive politike u janë dhënë shembuj të partive të tjera që kanë pësuar reforma të integritetit, këshilla praktike, sugjerime dhe fletë pune që do të ndihmojnë në forcimin e mënyrës së funksionimit të partisë, me qëllimin përfundimtar të fitimit të besimit të qytetarëve.



# ÇFARË ËSHTË INTEGRITETI I PARTISË POLITIKE DHE PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM

## Çfarë është Integriteti i partisë politike?

Partitë politike duhet të luajnë rol kyç në qeverisjen demokratike duke përfaqësuar qytetarët dhe duke përmbledhur shqetësimet e tyre në politika, ndërsa me anë të vetingut, të përzgjedhin dhe ndikojnë tek liderët politikë. **Sidoqoftë, korrupsioni, kapja e shtetit, popullizmin, dhe organizatat e errëta partiake minojnë besimin e publikut në partitë në të gjithë botën, duke nxitur paqëndrueshmërinë politike.** Qytetarët gjithnjë e më shumë i perceptojnë partitë si të drejtuar nga elita dhe jo përfaqësues të qytetarisë më të gjerë; jo të gatshëm për të përfshirë dhe fuqizuar gratë dhe bashkësi të tjera historikisht të nënpërfaqësuar; të papërkushtuar për transparencë dhe përgjegjshmëri; dhe përgjithësisht jo të besueshëm.

Një zgjidhje, e dëshmuar të bëjë ndryshim në ndryshimin e perceptimeve, është **kur partitë zgjedhin të dizajnojnë sistemet, qëllimin dhe etikën e tyre rreth parimit të integritetit.** Në mënyrë të konsiderueshme, kjo është edhe rruga që do të çojë në ndryshimet më domethënëse në mënyrën se si partitë politike vlerësohen nga votuesit.

**Për qëllimet e kësaj kornize, integriteti i brendshëm i partisë politike është i definuar gjerësisht si:**



**Organizim politik me qytetarin në qendër.** Integriteti partiak përfshin veprimin për interesat më të mira të qytetarëve. Një partie të zgjedhur në detyrë i është dhënë mundësia dhe privilegji të shërbejnë përmes politikës. Integriteti ka të bëjë gjithashtu me përqendrimin në shërbim: liderët e partive, zyrtarët e zgjedhur dhe anëtarësia e përgjithshme vijnë në politikë dhe qeverisje si shërbyes publik.



**Përqafimi i larmisë, barazisë dhe përfshirjes.** Integriteti i partisë njih dhe kërkon të adresojë pengesat institucionale, sociale, kulturore dhe individuale të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar (p.sh., gra, të rinj, persona me aftësi të kufizuara, orientim seksual dhe pakicat me shprehje të ndryshme gjinore, dhe pakicat etnike dhe fetare). Integriteti kërkon krijimin e një mjedisi mundësues për këto grupe që ato të marrin pjesë në mënyrë të konsiderueshme dhe të konsiderohen seriozisht në organet vendimmarrëse dhe të shërbejnë në role të tjera të larta drejtuese.




**Vendimmarrje përfshirëse.** Integriteti i partisë ndërton dhe zbaton mekanizmat që sigurojnë që të gjithë anëtarët e partisë (përfshirë bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar) dhe degët brenda strukturës së partisë të kenë mundësinë për të diskutuar mundësitë të kontribuojnë me ide dhe të ndikojnë në vendimmarrjen e partisë.



**Sjellje dhe praktika etike, transparente dhe llogaridhënëse** Integriteti partiak ndërton sisteme dhe praktika të sjelljes etike dhe llogaridhënëse për liderët partiak, zyrtarët e zgjedhur, dhe anëtarësinë e përgjithshme që e bëjnë partinë funksionale. Kjo gjithashtu vazhdon edhe tek ajo se si partia trajton të tjerët (d.m.th. konkurrentët politik) jashtë partisë. Për më tepër, integriteti përfshin një administrim të rreptë të fondeve publike dhe donacioneve të qytetarëve dhe parandalimin dhe refuzimin e akteve që mund të çojnë në përfitime financiare personale në kurriz të besimit të publikut ose përgjegjësisë së matur financiare.

**Figura 1: Integriteti i brendshëm i partisë politike**



**Për të arritur integritet politik, partitë politike duhet të vlerësojnë rregullisht praktikat e brendshme, të identifikojnë sferat për përmirësim dhe të zbatojnë reforma të qëndrueshme në lidhje me:**

- **Strukturat organizative dhe proceset e brendshme** që përfshijnë vendimmarrjen përfshirëse, si zgjidhen anëtarët, personeli dhe liderët partiak dhe si janë të zbatuara monitorimi efektiv dhe proceset e harmonizimit dhe të ankesave;
- **Kultura organizative** që nxisin sjelljen etike dhe llogaridhënese të anëtarëve partiak, personelit, liderëve partiak dhe zyrtarëve të zgjedhur dhe theksojnë fokusin e përqendruar në shërbim të qytetarëve.
- **Vetingu i kandidatëve dhe proceset e përzgjedhjes** që vendosin standardet etike dhe të definuara qartë për përfaqësim të partisë në qeverisje;
- **Diversiteti, barazia, dhe përfshirja, ku gratë, të rinjtë dhe bashkësitë e tjera historikisht të nënpërfaqësuar përfshihen në mënyrë të konsiderueshme brenda strukturës partiake,** si kandidate dhe në vendimmarrje; dhe
- **Mbledhja e fondeve politike dhe menaxhimi financiar** që janë transparent, etik dhe në përputhje me kornizat ligjore të vendit dhe nën ligjet e brendshme që qeverisin partinë.

**Integriteti është si personal ashtu edhe kolektiv. Qëllimi i tij është të rikthejë besimin e qytetarëve në partitë dhe të përmirësojë aftësinë e demokracisë për të realizuar nevojat e qytetarëve që janë në zhvillim e sipër.**

Nga perspektiva kolektive, është parimi rreth të cilit partitë ndërtojnë sisteme operative të shëndosha. Kjo do të thotë që proceset, procedurat dhe sjellja e brendshme e një partie, jo vetëm që ftojnë në veprim principiell por përfshijnë edhe mekanizmat për parandalim dhe reagim për t'iu shmangur akteve joetike.

Integriteti i mirëfilltë gjithashtu kërkon edhe përkushtimin e individëve—një gjest apo betim që duhet të ripërtrihet në bazë të rregullt para paqëndrueshmërisë dhe sfidave të ndërlikuara—dhe mundësitë që janë të qenësishme në jetën politike dhe publike.

Aspektet kolektive dhe individuale të integritetit janë simbiotike. Secila mund të përforcohet dhe ushqehet nga tjetra. Njëllor, veprimet e gabuara të njërit rrezikojnë të tjerët gjithashtu.

Këto karakteristika të brendshme të partisë njihen në literaturën akademike dhe praktikuese si diçka e natyrshme në sistemet e shëndosha politike. Studiuesit tregojnë se partitë politike me integritet të fortë të brendshëm avancojnë zgjedhje të besueshme, regjime transparente të financimit politik, media me të vërtetë të pavarura dhe procese politike pa korrupsion dhe konflikt interesi.

## Përse është i rëndësishëm integriteti i partisë politike?

Pasi që roli i një partie është fundamental për shëndetin e sistemeve sociale, kur ata dështojnë pasojat kumbojnë edhe përtej sektorit të kufizuar të politikës. Paqëndrueshmëria politike është terren pjellor për varfërinë, pabarazinë sociale dhe ekonomike, shpërnguljet, korrupsionin politik dhe vuajtjet njerëzore. Qytetarët

meritojnë nivelin më të lartë të përfaqësimit dhe kjo mund të realizohet vetëm nga parti politike të cilat i përkushtohen integritetit dhe demonstrojnë praktika të ndershme. Fatkeqësisht, shkalla globale ku partitë politike e arrijnë këtë është e ultë në mënyrë shqetësuese.

**Partitë politike duhet të demonstrojnë përkushtim më të madh për vlerat siç janë integriteti, të qenit të hapur dhe drejtësisë për të ndihmuar në rindërtimin e besimit të popullit.**

- Besimi në partitë politike është në nivele shqetësuese në të gjithë botën.<sup>5</sup>
- Kostoja e angazhimit në politikë po shkon lartë, duke e bërë kështu pjesëmarrjen politike më pak të arritshme dhe më të hapur për korrupsion financiar.<sup>6</sup>
- Konkurrenca politike dhe debati janë të perceptuar se po bëhen më pak civile dhe në të shumtën e rasteve më të dhunshme dhe ndarëse<sup>7</sup>, që pastaj po përforcohet përmes mediave sociale dhe digjitale.

Për **të përmirësuar aftësinë e një partie për të përfituar besimin e qytetarëve**, ata duhet të jenë burim i vizionit, të japin rezultate dhe të kenë kontakte midis popullsive të ndryshme. Partitë duhet të veprojnë si mekanizma përmes të cilave qytetarët marrin pjesë në vendimmarrje. Pritjet e shoqërisë për integritet ndryshojnë me kalimin e kohës pasi qytetarët presin rritjen e transparencës dhe sjelljen parimore. Partitë duhet të rishikohen dhe të përshtaten me kalimin e kohës. Qoftë në pushtet apo në opozitë, partitë politike duhet të jenë të afta të qeverisin—të kuptojnë dhe zgjedhin probleme komplekse, të ndërlikuara dhe zakonisht të shtrenjta.



# SI TË PËRDORET VLERËSIMI FITO ME INTEGRITET

Vlerësimi Fito me integritet është dizajnuar për të përmirësuar integritetin e brendshëm partiak. I drejtohet si individëve brenda partisë politike dhe kolektivit që angazhohen për udhëheqje politike dhe integritet. Vetëreflektimi dhe vlerësimi duhet të jenë praktikë e rregullt për cilëndo organizatë si pjesë e kulturës së vet për mësim, përmirësim dhe rritje. Vlerësimet janë vegla të dobishme për ndërtim apo rekrutim dhe mund të ndihmojnë partitë të identifikojnë mënyra për të përmirësuar strukturat e tyre dhe për të fituar besimin e qytetarëve.

**Nuk ka një mënyrë të “drejtë,” të “vetme” apo “një madhësi përshtatet për të gjithë” se si të kryhet një vlerësim i brendshëm. Se si një parti kryen një vlerësim të integritetit varet nga disa faktorë duke përfshirë këtu dhe kohën që është në dispozicion, motivimet që qëndrojnë pas vlerësimit, përkushtimin apo gatishmërinë e zyrtarëve të lartë të partisë (në nivel kombëtar dhe lokal) dhe disponueshmërinë e resurseve. Sidoqoftë, parimet themelore në lidhje me integritetin e partisë politike janë të gjitha të njëjta.**

Proceset e besueshme të vlerësimit duhet të përfshijnë sa më shumë anëtarë të organizatës që të jetë e mundur për të fituar informatën e dëshiruar në një mjedis të lirë nga friga nga masat ndëshkimore apo hakmarrja për reagime të sinqerta. Liderët duhet të jenë të hapur ndaj kritikës dhe informatave kthyesë dhe të gjejnë mënyra për të demonstruar se po i dëgjojnë anëtarët e partisë, përkrahësit, zyrtarët e zgjedhur dhe personelin partiak. Njerëzit zakonisht më shumë investojnë në organizatat ku ndjehen se janë të dëgjuar dhe ku udhëheqësia i merr parasysh mendimet e tyre. Një proces i besueshëm i vlerësimit nuk është vetëm të pyeten pyetjet, është e rëndësishme që ajo të çojë drejt zhvillimit të përgjigjeve dhe veprave që tregojnë se partia ka marrë parasysh përgjigjet. Realizimi i vlerësimit me pasim apo informata kthyesë të kufizuara është mënyra më e sigurt të tëhuajsohen njerëzit që janë kujdesur mjaft për t’iu përgjigjur pyetjeve në rradhë të parë. Mosveprimi mbi bazë të rezultateve të vlerësimit do të tëhuajsojë gjithashtu anëtarët e përkushtuar të partisë që duan të forcojnë partinë që të jetë më efektive dhe e besueshme.

### **Përfitimet nga realizimi i një vlerësimi Fito me integritet**

Ka dy përfitime kryesore për partitë në kryerjen e vlerësimeve për integritet. E para është mundësia për të angazhuar anëtarët partiak në një aktivitet domethënës midis dy zgjedhjeve. Kur anëtarët partiak janë në gjendje të japin një kontribut të konsiderueshëm në organizimin e partisë dhe kulturën, ka të ngjarë të ndjejnë një ndjenjë të pronësisë në promovimin e vlerave të partisë dhe suksesin gjatë

zgjedhjeve. Përfitimi i dytë është aftësia e partisë për të fituar apo rikthyer besimin tek qytetarët skeptik dhe të zhgënjyer. Votuesit që e dinë që një parti politike është serioze në lidhje me integritetin e brendshëm dhe përmirësimin e strukturave të veta ka të ngjarë që do të udhëheq me integritet gjithashtu. Votuesit e dinë kur një parti politike është serioze në lidhje me integritetin e brendshëm dhe për përmirësimin e praktikave të saj. Zbatimi i reformave mund të jetë një strategji efektive e komunikimit për partitë.

## **Si të realizohet vlerësimi Fito me integritet**

Mjeti për vlerësim Fito me integritet në këtë kornizë është dizajnuar për partitë politike që kanë integritetin në plan për ta përdorur vetë me ose pa mbështetje nga jashtë. Disa nga bisedat rreth kulturës apo praktikave të një partie politike mund të jenë të ndjeshme apo të vështira, ndërsa një mjedis i brendshëm mund ta bëjë më të lehtë që të iniciojë një debat të brendshëm dhe një plan të përshtatshëm për integritet/reforma. Sidoqoftë, nëse një parti është e gatshme t'a bëjë këtë, ekziston gjithashtu një vlerë unike për të sjellë një lehtësues të jashtëm me përvojë, të paanshëm dhe të besuar për të udhëhequr organizatën përmes vlerësimit të integritetit. Nuk është gjithnjë e mundur që të shohim problemet apo sfidat tona, veçanërisht kur ndryshimet ndodhin me kalimin e kohës. Edhe pse është më mirë t'i nënshtrohemi vetëvlerësimit të plotë, partitë mund të zgjedhin të përqendrohen në një ose më shumë seksione vlerësimi nëse ka çështje urgjente që duhet të adresohen në një periudhë të shkurtër kohe. Çdo përparim në integritetin e brendshëm të partisë është i vlefshëm.

## **Krijimi i një ekipi për vlerësim brenda partisë**

Përveç këshillave të lartpërmendura, nëse një parti vendos të iniciojë një vlerësim të integritetit, e njëjta duhet të jetë e organizuar dhe e drejtuar nga një ekip i përkushtuar. Ekipi kryesor ideal i vlerësimit duhet të përbëhet nga individë të cilët kanë nivel të lartë të integritetit dhe mundësisht do të përfshijë si udhëheqësinë e lartë në nivel kombëtar dhe të degëve të cilët kanë fuqinë dhe veglat për të ndërruar sistemin ashtu edhe anëtarësia dhe aktivistët në bazë. Diversiteti demografik brenda ekipit është gjithashtu vendimtar; gratë dhe burrat duhet të jenë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë tek pjesëtarët e vlerësimit. Duhet të bëhen përpjekje që të përfshihen edhe aktivistë rinor si dhe përfaqësues të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar. Përderisa pyetjeve të vlerësimit duhet t'iu përgjigjen një mostër e besueshme përfaqësuese e anëtarëve të partisë, ekipi kryesor është përgjegjës për analizimin e rezultateve, propozimin e rekomandimeve dhe dakordimin për një plan zbatimi.

## **Përdorimi i një lehtësuesi të brendshëm**

Siç u përmend më lartë, disa biseda për reforma të brendshme të partisë janë të ndjeshme dhe partia mund të preferojë të kryejë një vlerësim të integritetit pa përfshirë një lehtësues nga jashtë. Ekipi kryesor për vlerësim mund të zgjedhë një apo më shumë individ për të organizuar mbledhjen e përgjigjeve nga pyetjet e vlerësimit si dhe të kryejë fokus grupe apo punëtori, për të përfunduar një depërtim shtesë në gjetjet e vlerësimit nëse në parti ka individë të caktuar që kanë aftësi për bërë rolin e lehtësuesit.

## Përdorimi i një lehtësuesi të jashtëm

Angazhimi i një lehtësuesi nga jashtë lejon një analizë të paanshme të nivelit të integritetit të një partie politike pasi që vlerësimi të jetë plotësuar. Një lehtësues i jashtëm gjithashtu mund të identifikojë rekomandimet për reformë. Identifikimi i personit të duhur është kyç për të fituar besimin dhe për të siguruar sinqeritet nga anëtarët e partisë gjatë diskutimit analizues. Përfshirja e anëtarëve partiak në emërimin apo sugjerimin e lehtësuesve të besueshëm do të ndihmojë në udhëheqjen e vendimit për të zgjedhur dikë që është i besueshëm. Një lehtësues i jashtëm duhet të ketë qasje të papenguar, të pavarur deri tek të gjithë anëtarët e partisë dhe rezultatet e vlerësimit për të analizuar në mënyrë efektive nivelin e integritetit të partisë dhe për të bërë rekomandime të mundshme për reformën. Udhëheqësia partiake nuk duhet të bëjë mikromenaxhimin e lehtësuesit të jashtëm dhe duhet të mbajë distancë nga procesi. Krahas kësaj kornize, një lehtësues i jashtëm mund gjithashtu të kryejë diskutime pjesëmarrëse në fokus grupe me anëtarë të partive për të marrë më shumë informata lidhur me integritetin partiak.

## Zgjerimi i pjesëmarrjes në vlerësimin e integritetit për anëtarë shtesë të partisë

Rezultatet e integritetit të partisë pasqyrojnë përshtypjet dhe njohuritë e ekipit vlerësues se si partia operon përgjatë pesë dimensioneve:

- Struktura organizative dhe proceset e brendshme;
- Kultura organizative;
- Vetingu dhe përzgjedhja e kandidatit;
- Diversiteti, barazia dhe përfshirja; dhe
- Mbledhja e fondeve dhe menaxhimi financiar.

Ekipi kryesor i vlerësimit të integritetit duhet të pasqyrojë një prerje tërthore të partisë dhe mund të dëshirojë të zgjerojë pjesëmarrjen duke përfshirë anëtarë shtesë të partisë pasi të ketë përfunduar vlerësimi fillestar nga ekipi.








Në Kolumbi, ekipi i vlerësimit të integritetit të një partie zgjeroi pjesëmarrjen për të përfshirë një pjesë më të madhe të zyrtarëve dhe anëtarëve të partisë. Rezultatet nga vlerësimi i zgjeruar lejuan që partia të ketë një pamje më gjithëpërfshirëse për shkallën në të cilën ekziston integriteti dhe se sa janë të ditur anëtarët për rregulloret dhe praktikën e brendshme të partisë. Si rezultat, partia përdori rezultatet e zgjeruara për të informuar aktivitetet e planifikimit strategjik.



Për të zgjeruar sondazhin e vlerësimit të integritetit, partia duhet të marrë vendime strategjike duke gjetur ekuilibrin e duhur ndërmjet plotësimit të sondazhit nga e gjithë anëtarësia e partisë dhe zgjedhjes strategjike të anëtarëve. Për shembull:

Qasja	Fuqitë	Dobësitë
Vetëm ekipi i vlerësimit të integritetit e plotëson sondazhin	Përfshin një grup të larmishëm individësh nga udhëheqja e partisë, degët dhe grupet e brendshme të interesit të partisë (p.sh. krahët e grave, krahët e rinisë)	Përfaqëson një mostër të vogël të partisë
Ekipi i vlerësimit të Integritetit zgjeron pjesëmarrjen në sondazh për një grup shumë të zgjedhur të anëtarëve shtesë	Siguron një pamje më gjithëpërfshirëse të integritetit të partisë duke përfshirë një grup të larmishëm individësh nga partia që dinë se si funksionon partia si dhe të tjerët që mund të largohen nga proceset e brendshme	Identifikimi dhe kryerja e një përzgjedhjeje strategjike të anëtarëve shtesë jashtë Ekipit të vlerësimit të integritetit mund të përfaqësojë një sfidë
Të gjithë anëtarët e partisë e kryejnë sondazhin	Përfshin një qasje për tërë partinë për të kuptuar shkallën në të cilën partia ka integritet	Gjetjet nga sondazhi, ndjekja dhe identifikimi i reformave bëhen të vështira për t'u menaxhuar

**Nëse vlerësimi është një proces i brendshëm, vetë-drejtues ose përdoret një lehtësues i jashtëm, më poshtë janë disa këshilla të dobishme për përgatitjen për të përdorur kornizën e vlerësimit:**

	Përcaktoni kohën e vërtetë për të realizuar vlerësimin. Partitë kanë prioritete të shumta, ndërsa ngjarjet afatshkurta ose urgjente si zgjedhjet shpesh shtyjnë aktivitetet afatgjata të orientuara nga proceset, për më vonë. Përderisa fushatat zgjedhore janë, me të drejtë, prioritete urgjente, mos lejoni që ato të bëhen arsyetim për të shtyrë apo anuluar nismën për reforma integriteti.
	Vendosni se kush duhet të merr pjesë. Përderisa është e dëshirueshme që të merrni shumë mendime dhe pikëpamje, nuk është gjithnjë e efikase dhe as të gjithë nuk i shtojnë vlerë çdo rreshti të pyetjeve. Për shembull, anëtarët e rëndomë të partisë nuk e dinë domosdoshmërisht se si menaxhohen financat e partisë, kështu që angazhimi i tyre në vlerësimin e integritetit financiar mund të mos jetë i rëndësishëm. Partia duhet të gjejë një ekuilibër midis një përzgjedhjeje gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese të anëtarëve të partisë dhe një numri të menaxhueshëm të pjesëmarrësve.
	Të vendoset se si partia do të mbledhë informatat. A do të kryejë fokus gupe të vogla me lehtësues apo punëtori? A do të'i pyesë të anketuarit për të plotësuar fletët e punës së Fito me integritet? A do të plotësojnë njerëzit kopje fizike të fletëve të punës apo do të hartojë partia një pyetësor në internet?
	Jini i qartë dhe transparent me anëtarët e partisë për qëllimin e vlerësimit. Përse po e bën këtë tani partia? A ka krizë apo procesi për vlerësim do të jetë një vegël e rregullt për rritjen partiake?
	Siguroni anëtarët e partisë se ekipi për integritet partiak është sinqerisht i interesuar në vlerësimet e sinqerta dhe nuk do të ketë kurrfarë ndëshkimi apo hakmarrjeje për kritikën apo vërejtjet negative.
	Ua bëni me dije anëtarëve të partisë se çka pritet prej tyre. Sa kohë do t'iu duhet për të plotësuar anketën? A do të marrin pjesë në fokus grup? A do të jenë përgjigjet anonime?
	Shpjegoni se çfarë do të ndodhë pas vlerësimit dhe caktoni pritje realiste. Kush do të dijë rezultatet? Kush do të evalulojë vlerësimin dhe bëjë rekomandimet për ndryshim? Si do të zbatohen rezultatet?

## Shkalla e integritetit dhe shënimi i pikëve

Një shkallë integriteti gjindet në fundin e çdo pjese të vlerësimit. Qëllimi i kësaj shkalle është t'i ndihmojë ekipit për integritet të partisë në bërjen e prioriteteve për fushat e reformave. Njerëz të ndryshëm kanë perceptime të ndryshme për atë se si funksionon partia dhe si zbaton dhe promovon çështjet që kanë të bëjnë me integritetin. Andaj, idealisht, çdo anëtar i ekipi për integritet të partisë do të kryejë vlerësimin individualisht para se të bëhen bashkë për të krahasuar dhe përmbledhur të gjitha rezultatet në një vend. Ekipi i integritetit do të merr mesataren nga të gjitha rezultatet për të përcaktuar ku partia dështon në shkallën e integritetit.

Kategoritë e pikëve të integritetit	Përqindja
Niveli i lartë i integritetit	86%-100%
Integriteti i pranishëm	71%-85%
Integriteti në rrezik! Vlerësoni praktikat e brendshme	51%-70%
Kërkohet reformë e integritetit	50% ose më pak

**Për shembull, imagjinoni që ekipi i integritetit i një partie ka pesë anëtarë. Për të gjetur mesataren, ekipi duhet të mbledhë rezultatet e të gjithë pesë anëtarëve, pastaj të pjesëtojë shumën me pesë.**

Nëse ekipi ka 10 anëtarë, partia duhet të mbledhë rezultatet e të gjithë 10 anëtarëve, pastaj të pjesëtojë numrin me 10 dhe kështu me rradhë.

**Për të ndihmuar në këtë proces, partia mund të përdorë mjete të tilla si Google Sheets ose Microsoft Excel për të regjistruar përgjigjet dhe për të llogaritur më lehtë rezultatet e integritetit duke përdorur “Formulën mesatare”. Përdorimi i mjeteve për të llogaritur rezultatet e integritetit të partisë siguron saktësinë në të dhënat që përndryshe mund të bëhen dërmuese dhe të lodhshme.**

Pasi që ekipi i integritetit të kalkulojë rezultatin e integritetit, ata mund të fillojnë diskutimin se përse partia vepron në atë mënyrë që vepron dhe të identifikojë reformat e brendshme për të përmirësuar partinë e tyre. Pjesa 4 dhe 5 në kornizë do të ndihmojë partitë të zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë progresin drejt qëllimeve të tyre të integritetit.

**Tabela 1: Shembull ilustrues për gjetjen e rezultatit të integritetit partiak**

Pjesa e vlerësimit: Struktura organizative dhe proceset e brendshme	
Anëtari 1 i partisë	Rezultati: 42
Anëtari 2 i partisë	Rezultati: 59
Anëtari 3 i partisë	Rezultati: 55
Anëtari 4 i partisë	Rezultati: 67
Anëtari 5 i partisë	Rezultati: 48
Rezultati i përgjithshëm	271
<b>Mesatarja (Rezultati i përgjithshëm ÷ Numri i anëtarëve të ekipit për integritet të partisë)</b>	<b>54 rezultati i integritetit i partisë</b>

Shkalla e integritetit	Kërkohen reforma të integritetit	Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme	Integriteti prezent	Niveli i lartë i integritetit
Rezultati i përgjithshëm	0-40	41-56	57-68	69-80

Partia ime rezultoi me **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme** në shkallën e integritetit për **Struktura organizative dhe proceset e brendshme**.

#### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.

# VLERËSIMI FITO ME INTEGRITET

## I. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PROCESET E BRENDSHME



Partitë politike janë mjete për shrehje politike që kërkojnë një rol në vendimmarjen publike.<sup>8</sup> Si të tilla, ata kërkojnë strukturë, rend dhe rregullim të brendshëm për të siguruar se ata mund të kryejnë këtë funksion profesionalisht, efektivisht dhe etikisht.

Korniza rregullatore që e miratojnë partitë politike varet nga kërkesat ligjore vendore, realitetet gjeografike, origjina partiake e formimit, madhësia e saj, resurset dhe ambicjet dhe deri diku dhe ideologjia e saj. Kushtetutat, nënligjet, rregullimet, statutet, rregulloret dhe/ose deklaratat për vlerat dhe vizionin janë të gjitha përdorura nga partitë për të përkufizuar qëllimet e tyre dhe se si do të sillen si organizata. Dokumentet të cilat rregullojnë strukturat dhe proceset organizative duhet të jenë udhëzues “të gjallë” për tu rishikuar dhe përditësuar me zhvillimin e vet partisë. Cila do nga këto nëse zbatohet, ka disa karakteristika që ndikojnë nëse dokumentet udhëheqëse primare të partisë e ndërtojnë apo dëmtojnë integritetin.

Kjo pjesë, andaj, fokusohet në rregullimet brenda partisë që drejtojnë strukturat organizative dhe proceset e vendimmarjes. Shqyrton rregullat që rregullojnë anëtarësimin, përzgjedhjen e kryesisë dhe mënyrën se si partia menaxhon debatet dhe mosmarrëveshjet brenda organizatës.

### Strukturat organizative dhe vendimmarja

Si sillen vendimet dhe si komunikohen ato—dhe kush sjell ato vendime—ndikon fuqishëm në atë se sa ndjehen të lidhur anëtarët dhe votuesit me partitë politike. Anëtarët e partive politike zakonisht nuk ndjehen mjaft të angazhuar pasi ata vetëm miratojnë vendimet e kryesisë. Një parti e vërtetë përfshirëse krijon mundësi për të menduar, diskutuar dhe debatuar politikën dhe çështjet nga degët lokale deri tek ekzekutivi i partisë. Krahas kësaj, një parti përfshirëse inkurajon si anëtarët ashtu dhe votuesit për tu angazhuar më shumë me organizatën.<sup>9</sup>


Dokumentet e partisë duhet të definojnë organet dhe komisionet e brendshme partiake (duke përfshirë degët ndihmëse dhe lokale ose rajonale) dhe të përcaktojnë autoritetin e tyre, proceset e vendimmarjes dhe mënyrën sesi organet e ndryshme lidhen me njëri-tjetrin. Organet partiake duhet të kenë burime të mjaftueshme (apo të fuqizohen të ngrisin dhe ndajnë burime) me një nivel të caktuar të autonomisë për t'u angazhuar në aktivitete që kontribuojnë në rritjen partiake. Statutet

partiake duhet gjithashtu të definojnë anëtarësinë e organeve dhe të vendosin se si përzgjidhen ato, krahas përkrahjes së standardeve që reflektojnë ideologjinë e partisë, udhëheqësinë dhe integritetin. Procedurat me shkrim duhet të artikulojnë se si organet e organizatës integrojnë përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave dhe veprimet pozitive për integrimin e popullsisë, grupeve ose bashkësive të nënpërfaqësuar si dhe akomodimin e personave me aftësi të kufizuara.

Shpesh, partitë nuk i themelojnë të gjitha organet e parapara me dokumentet e themelimit, e as që i ndjekin gjithmonë rregullat e vendimmarjes apo respektimin e autoriteteve të organeve të ndryshme, por është e pamundur të reformohen apo të merren në llogari proceset që nuk janë të përshkruara në dokumentet e partisë.

## Përmirësimi i strukturave partiake në Marok

Në Marok, partitë Lëvizja Popullore (LP) dhe Bashkimi Kushtetues (BK), kanë iniciuar dhe zbatuar masa për të ritur rolet dhe përgjegjësitë e degëve të tyre rajonale, që do të mundësonin më shumë kontroll lokal dhe të përmirësojnë qasjen e qytetarëve. BK ndryshoi direktivën e këshillave të saj rajonal nga nga organe vetëm diskutuese në organet kryesore vendimmarrëse në rajon. Riafrimimi i përkushtimit të partisë për të përmirësuar qasjen e qytetarëve, sekretari i përgjithshëm i LP kërkoi publikisht nga degët rajonale të përmirësojnë organizimin e brendshëm, duke shpjeguar se qasja efektive e qytetarëve në nivelet rajonale dhe ato lokale por nuk mund të kryhet në mënyrë efektive nëse nuk janë të strukturuar dhe organizuar si duhet zyrat e degëve.



## Përzgjedhja e anëtarësisë, kryesisë dhe personelit

Duhet të jetë qartë e artikuluar dhe definuar me dokumentet partiake se kush mund të jetë anëtar, të udhëheqë dhe të punojë për partinë.<sup>10</sup> Statutet e partive ose aktet nënligjore duhet të definojnë kërkesat për **anëtarësim** dhe të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve brenda partisë. Kërkesat për anëtarësim mund të përfshijnë moshën minimale dhe dispozitat që ndalojnë anëtarësinë në një parti tjetër. Të drejtat e anëtarëve zakonisht përfshijnë mundësitë për pjesëmarrje në procedurat për përzgjedhje të kandidatëve apo kryesisë, si dhe proceset e tjera të vendimmarjes specifike për partitë. Pagimi i detyrimeve, promovimi i synimeve dhe objektivave të partisë dhe respektimi i rregullave të partisë janë përgjegjësitë standarde të anëtarësimin. Zakonisht, rregullat e partisë gjithashtu përcaktojnë procedurat për shkarkimin e një anëtari.

Partitë politike përfitojnë nga rregullat e qarta për zgjedhjen e **udhëheqësve** të partive. Në shumicën e partive, organi më i lartë vendimmarrës është kongresi, konferenca apo konventa. Kjo strukturë zakonisht ndryshimet në dokumentet dhe politikat primare të partive, ka përgjegjësi të caktuar



për përzgjedhjen e kryesisë dhe bën vendime të tjera të rëndësishme. Pasi këto organe takohen me shpeshësi të ndryshme, partitë politike bëjnë dispozita që një strukturë të mbikqyrë dhe udhëheqë punën e partisë midis dy kongreseve. Në mënyrë tipike, ekziston një këshill apo bord ekzekutiv, i drejtuar nga udhëheqësi i partisë dhe i përbërë nga drejtues të lartë të partisë. Në minimum, udhëzimet e shkruara duhet të artikulojnë se cilët individë apo entitete përbëjnë ekipin udhëheqës dhe si zgjidhet ai (dhe anëtarët e tij), mandati i postit dhe kujt i përgjigjen. Partitë me nivel të lartë të integritetit priren gjithashtu të kenë pjesëmarrje të gjerë brenda partisë në përzgjedhjen e kryesisë së partisë.

Shumica e partive dallojnë zyrtarët që janë përgjegjës për përcaktimin e strategjisë së partisë dhe **personelin** e ngarkuar me zbatimin dhe administrimin e vendimeve që merr partia. Në mënyrë tipike, personeli administrativ nuk mund të kërkojë pozicione të tjera brenda partisë—për shembull emërim si kandidat i partisë për një zyrë të zgjedhur publik . Kjo ndarje ndihmon për të siguruar që personeli administrativ të jetë plotësisht i përgjegjshëm ndaj liderëve të partive dhe të mos përdorë makinerinë e partisë për qëllimet e tyre politike. Shpesh, zgjidhen zyrtarë me përgjegjësi kryesisht politike dhe kështu gëzojnë një mandat të gjerë nga partia. Personeli administrativ mund të emërohet nga udhëheqësia politike ose të zgjedhet, por zakonisht do të punojë nën mbikëqyrjen e ngushtë të udhëheqësisë politike.

Krahas artikulimit të kriterëve dhe përzgjedhjes për anëtarët, udhëheqësit dhe personelin, partitë politike duhet të mbrojnë rolet dhe përgjegjësitë e individëve që përbëjnë organizatën. Dokumentet e partisë duhet të përfshijnë kodet e sjelljes, anti-ngacmimin, anti-diskriminimin dhe barazinë gjinore, diversitetin dhe politikën për rininë. Për të avancuar integritetin e partisë, ato duhet të vendosin rregulla për zero tolerancë për individët që bëjnë keqpërdorime financiare brenda ose jashtë partisë.

## Proceset e monitorimit, pajtueshmërisë dhe ankesave

Të gjitha organizatat që angazhohen për integritet kanë mekanizma për të monitoruar dhe siguruar që individët i respektojnë rregullat dhe vet ata sillen në mënyrë etike. Rregullat e partive politike duhet të deklarojnë qartë se cili organ ose komision është përgjegjës për monitorimin e shkeljeve të akteve nënligjore ose të kodeve të sjelljes. Personeli i partisë dhe ai administrativ duhet të gëzojnë kushte të drejta në vendin e punës pa diskriminim, bullizëm dhe ngacmim, të udhëhequr nga politikën konvencionale të burimeve njerëzore.

Në partitë politike demokratike, është edhe e pashmangshme dhe e dëshirueshme që anëtarët e përkushtuar dhe të apasionuar të marrin pjesë në debatet e brendshme mbi vendimet. Rregullat e partisë duhet të parashikojnë konfliktet dhe duhet të sigurojnë korniza për nxitjen e një debati konstruktiv brenda partiak. Rregullat për gjykimin e brendshëm të konflikteve mund të parandalojnë që mosmarrëveshjet të mos përshkallëzohen, duke e bërë më pak të mundshme që ato përhapen jashtë partisë kur anëtarët e dëmtuar t'i përcjellin shqetësimet e tyre deri tek populli. Statutet ose aktet nënligjore mund të parashikojnë pasjen e organeve të brendshme të pavarura për ankesa të cilat mund të shqyrtojnë dhe gjykojnë mosmarrëveshjet midis institucionit parti dhe anëtarëve individual ose midis strukturave të ndryshme të partisë. Përderisa anëtarët e dëmtuar meritojnë mundësi për të kërkuar dëmshpërblim, udhëheqësia duhet gjithashtu të ketë mundësinë e sanksionimit të anëtarëve kokëfortë, veprimet e të cilëve janë kërcënim për partinë. Prandaj, partitë duhet të konsiderojnë një kombinim të masave që mbrojnë partinë ndërsa adresojnë nevojat dhe shqetësimet e mundshme të anëtarëve të dëmtuar.

## PYETJET PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT



### STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PROCESET E BRENDSHME

Ekzistojnë dispozita të shkruara për strukturën dhe qeverisjen e përgjithshme të partisë sime që plotësojnë standardet minimale ligjore.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Ekziston përkushtim me shkrim për pjesëmarrje të barabartë të grave në partinë time.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka vlerësuar aktet e saja nënligjore lidhur me pengesat e natyrshme për pjesëmarrje të konsiderueshme të grave ose bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Në 10 vitet e fundit, praktikisht ka pasur një numër të barabartë të grave dhe burrave në komitetin ekzekutiv kombëtar të partisë sime (ose organin më të lartë vendimmarrës).

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Komiteti kombëtar ekzekutiv i partisë sime (ose organi më i lartë vendimmarrës) është, në praktikë, përfshirës i krahut të grave.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Dokumentet e partisë sime nënvizojnë angazhimin për diversitet, barazi dhe përfshirjen e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Komiteti kombëtar ekzekutiv i partisë sime (ose organi më i lartë vendimmarrës) është, në praktikë, përfshirës i pakicave etnike dhe atyre fetare.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Komiteti kombëtar ekzekutiv i partisë sime (ose organi më i lartë vendimmarrës) është, në praktikë, përfshirës i të rinjve (deri në moshën 35 vjeçare).

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Komiteti kombëtar ekzekutiv i partisë sime (ose organi më i lartë vendimmarrës) është, në praktikë, përfshirës i udhëheqësve të degëve të partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime ka të shkruar qartë qeverisjen e brendshme me mandate të dyfishta (p.sh., aftësinë apo paaftësinë e një politikani të zgjedhur për të shërbyer në poste të larta partiake të brendshme).

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka të shkruar qartë qeverisjen e brendshme dhe strukturën vendimmarrëse që sqaron entitetet e partisë dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Është i mundur revokimi i udhëheqësit nga ana e anëtarëve partiak që nuk i takojnë elitës.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Komiteti kombëtar ekzekutiv i partisë sime (ose organi më i lartë vendimmarrës) është, në praktikë, përfshirës i krahut të të rinjve.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Aktivistët e nivelit të mesëm dhe atij bazë ndikojnë në vendimet e partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Ekzistojnë mekanizma apo mundësi të tjera për të debatuar vendimet potenciale.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Statutet apo aktet nënligjore të partisë sime definojnë qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Në praktikë, anëtarësia e përgjithshme e partisë sime merr pjesë në zgjedhjen e kryesisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Statutet apo aktet nënligjore të partisë sime krijojnë një organ përgjegjës për monitorimin e shkeljeve të rregullave të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka rregulla të shkruara lidhur me ankesat dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve brenda partiakë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka të shkruara politikat për burimet njerëzore që rregullojnë punësimin ose angazhimin e personelit administrativ dhe profesional.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

## STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PROCESET E BRENDSHME

Shkalla e integritetit	Kërkohen reforma të integritetit	Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme	Integriteti prezent	Niveli i lartë i integritetit
Rezultati i përgjithshëm	0-40	41-56	57-68	69-80

**Partia ime morri \_\_\_\_\_ në shkallën e integritetit për Strukturat organizative dhe proceset e brendshme.**

### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.

## 2. KULTURA ORGANIZATIVE



Kultura e brendshme e çdo organizate është shtytësi kryesor i sjelljes së anëtarëve në të gjitha nivelet—nga zyrtarët më të lartë të partisë, deri tek votuesit dhe përkrahësit. Kultura e brendshme është mjedisi në të cilin anëtarët e partisë funksionojnë dhe gjithashtu përcakton vlerat dhe besimet e përgjithshme të një organizate ndaj opinionit të brendshëm dhe të jashtëm. Një përkufizim standard i kulturës organizative është “mënyra sesi i bëjmë gjërat këtu.”<sup>11</sup> Hulumentimi i konsiderueshëm si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat<sup>12</sup> ka identifikuar llojet e praktikave dhe sistemeve që kanë më shumë të ngjarë të promovojnë zgjedhje etike—dhe në përgjithësi parti politike më të shëndetshme—si dhe ato që mund të çojnë në një rritje të sjelljeve apo veprimeve joetike.

Partitë politike shpesh perceptojnë veten si organizata jashtë kornizës standarde të institucioneve sociale dhe ekonomike. Përderisa partitë kryejnë një detyrë vitale publike—përfaqësojnë nevojat dhe mendimet e votuesve dhe zhvillojnë dhe propozojnë ide për të kontribuar në qeverisjen e shoqërisë—ata nuk ofrojnë shërbim në të njëjtën mënyrë si do ta kishte bërë atë një shkollë apo një spital. E as janë partitë biznese private të fokusuara në produkte apo fitime. Shumica e partive politike janë diku në mes midis institucioneve publike që ofrojnë shërbime dhe bizneseve private.

Për më tepër, partitë politike janë të formuara nga ata që i udhëheqin ato. Votuesit dhe përkrahësit shpesh përqendrojnë vëmendjen joproportionale tek liderët e partive politike dhe presin që ata të jenë individë karizmatikë dhe tërheqës, duke rrezikuar zhvillimin e një “kulti të personalitetit”. Nëse sistemet dhe praktikët e partisë i përkasin preferencave ose tekave të liderit në kurriz të interesave më të mira të partisë politike në tërësi, standardet etike dhe praktikët më të mira, rrezikohen të mos merren parasysh ose të injorohen—madje edhe brenda organizatave politike që e konsiderojnë veten plotësisht parimore. Partitë politike që i nënshtrohen kulteve të personalitetit zakonisht përballen me jostabilitet, konflikt të brendshëm dhe kriza të vazhdimësisë së lidërsipit—veçanërisht pasi fuqia dhe ndikimi i udhëheqësve të fillojnë të veniten.

Në fund të fundit, partitë e suksesshme politike mbështeten në angazhimin konstruktiv të individëve (shpesh vullnetarëve) të cilët, si shumica e njerëzve, preferojnë ambiente pozitive ku respektohen kontributet e tyre. Në veçanti, organizatat që mbështeten në vullnetarë vuajnë nga kulturat negative të punës. Se si organizatat i trajtojnë njerëzit mund t’ju ndihmojë ata të lulëzojnë ose t’i tërheqin ata drejt dështimit ose kompromisit etik.

Kultura e brendshme e një partie politike ndikon fuqimisht mbi këtë spektër të lulëzimit dhe dështimit. Përjetimi i padrejtësisë, sjelljes abuzive, qëndrimeve egoiste ose hakmarrjes dhe ndëshkimit do të çojë çdo anëtar ose mbështetës të partisë të konkludojë se kultura e partisë jo vetëm që është jo mikpritëse, por dhe joetike, ndërsa zgjedhjet e tyre të sjelljes do të përputhen me këtë mjedis.<sup>13</sup> Njëlloj, nëse një palë perceptohet se ka ndërtuar sistemet dhe praktikët e saja mbi besimin, drejtësinë dhe standardet etike që zbatohen mbi të gjithë në organizatë, partia ka më shumë të ngjarë të që do të kultivojë nivele më të larta të përkushtimit, inovacionit konstruktiv dhe besnikërisë brenda radhëve të saj.

Prandaj, kjo pjesë përqendrohet në dinamikën e brendshme dhe praktikët e një partie politike që formojnë kulturën organizative, duke përfshirë standardet e sjelljes, reagimin ndaj sjelljeve të gabuara dhe sjelljes së udhëheqësisë. Ajo shqyrton shkallën në të cilën një parti, si një vend pune, është e denjë dhe respektuese për të gjithë ata që kontribuojnë në strukturën dhe qëllimin e partisë.

Edhe pse kjo pjesë përqendrohet në kulturën e brendshme organizative, **kultura e sjelljes së një partie politike ndaj bashkëbiseduesve të jashtëm është po aq e rëndësishme për shëndetin e një demokracie shumëpartiake.** Respekti për partitë e tjera oponente, qytetarët, mediat dhe institucionet demokratike dhe rolet e tyre legjitime forcojnë proceset politike.

## Standardet mbizotëruese të sjelljes së partive politike

Standardet e sjelljes pasqyrojnë “kontratën shoqërore” ose kodin e përbashkët të sjelljes brenda një partie politike si një entitet funksionues. Ato janë mënyra sesi partia zhvillon biznesin dhe si njerëzit lidhen me njëri-tjetrin brenda organizatës. Përderisa aktet nënligjore të partisë ose rregulloret e brendshme zakonisht artikulojnë aspektet formale të standardeve të sjelljes, aspektet e tyre më të fuqishme marrin formën në atë që partia praktikon me të vërtetë çdo ditë, përfshirë marrjen dhe komunikimin e vendimeve. Domosdoshmërisht, standardet e sjelljes dhe kultura e brendshme janë norma të drejtuara nga konsensusi që ndiqen dhe respektohen nga të gjithë në organizatë. Nëse nuk respektohen standardet e sjelljes së partisë, lidhshipi duhet të reagojë në mënyrë të duhur.

## Reagimi ndaj sjelljes së pahijshme

Se si një parti politike i përgjigjet rasteve të sjelljes së pahijshme brenda radhëve të saj është një tregues thelbësor i aftësisë së saj për të vepruar me integritet. Dokumentet partiake duhet të artikulojnë mekanizma transparentë për të trajtuar sjelljet e gabuara. Janë tre elementë thelbësorë për veprimet e një partie në këtë fushë. Së pari, burimet, sistemet dhe politikat duhet të lejojnë që personeli, zyrtarët dhe anëtarët përkatës të ngrisin çështjen për papërshtatshmëri duke e ditur që do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe profesionale. Së dyti, kultura e brendshme duhet ti shmanget ndëshkimit ose hakmarrjes kundër atyre që flasin ose shprehin shqetësimet. Më në fund, partia duhet të veprojë për të zbatuar mekanizma për të parandaluar sjelljet e gabuara dhe të penalizojë shkelësit, pavarësisht nga roli i tyre brenda partisë.

Një kulturë organizative e bazuar në integritet presupozon që ata që kontribuojnë në parti si personeli, zyrtarë, anëtarë dhe mbështetës mendojnë se ata kanë një nivel të caktuar kontrolli dhe përgjegjësie për rezultatet etike dhe se ekzistojnë sisteme të vendosura që mbështesin veprimet kundër incidenteve ose dukurive joetike.<sup>14</sup>

## Sjellja e udhëheqësisë

Nëse kultura e brendshme e një partie politike është e komprometuar ose është bërë toksike, problemet ka të ngjarë të kenë një lidhje të fortë me zgjedhjet e ekipit të udhëheqësisë së lartë ose dështimin e saj për të adresuar çështjet.

Udhëheqësia mund të ketë një ndikim të thellë në kulturën e brendshme të një organizate, duke përfshirë këtu nëse ose si zhvillohet dhe ndryshimet me kalimin e kohës. Aftësia për të njohur implikimet etike të një sfide ose situatë është një komponent kritik i vendimmarrjes parimore<sup>15</sup> Veprimet dhe sjellja e ekipit të lartë të udhëheqësisë vendosin standarde për mjedisin operativ të partisë dhe sinjalizojnë orientimin etik të partisë për të gjithë ata që janë brenda organizatës. Sjellja e lidhshipit gjithashtu i telegrafon publikun mënyrën se si një parti do të qeveriste dhe trajtonte qytetarët, nëse dhe kur ajo do të kishte atë mundësi.

Vlerësimi i kulturës së brendshme organizative është sfidues pasi normat e sjelljes janë shpesh sipas situatave dhe lëndë e interpretimit. Në thelb, pyetja themelore për kulturën organizative është nëse udhëheqësit angazhohen kryesisht në sjellje që forcon ose dobëson orientimin etik të partisë.

## Përmirësimi i kulturës organizative në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Partia Social Demokratike filloi një proces të gjerë këshillues për të zhvilluar një kod të etikës, duke përfshirë strukturat e ndryshme të partisë. Prosesi rezultoi me dokumentin e ri që u miratua zyrtarisht nga Bordi kryesor i partisë. Edhe pse ky dokument është një zhvillim i fundit në parti, anëtarët tashmë kanë filluar t'i referohen dispozitave të tij gjatë debateve dhe takimeve të partisë. Në Kosovë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kërkuan që të promovojnë dhe zbatojnë normat e sjelljes së përgjegjshme dhe etike. AAK integroi një kod të etikës në statutin e partisë, duke themeluar Komisionin për Etikë, ndërsa PDK ka miratuar një dispozitë statutore për etikë. Të dyja partitë i miratuan këto masa në vitin 2019 dhe filluan zbatimin e tyre me rastin e zgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve për zgjedhjet, si dhe promovimin e njerëzve me integritet në pozicionet partiake dhe qeveritare.



## PYETJET PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT



### KULTURA ORGANIZATIVE

#### Standardet mbizotëruese të sjelljes së partive politike

Unë kam lexuar kodin e brendshëm të sjelljes së partisë time.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime përfaqfon ide të reja për të zbatuar ndryshime brenda organizatës.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime ka një kod të brendshëm të shkruar të sjelljes dhe standarde të sjelljes.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Kodi i shkruar i sjelljes është i zbatueshëm dhe i mbështetur.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Anti-bullizmi është i adresuar në mënyrë të qartë në kodin e sjelljes.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Anti-diskriminimi është i adresuar në mënyrë të qartë në kodin e sjelljes.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Anti-ngacmimi është i adresuar në mënyrë të qartë në kodin e sjelljes.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Ngacmimi seksual adresohet në mënyrë të qartë në kodin e sjelljes.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4



Anti-dhuna adresohet në mënyrë të qartë në kodin e sjelljes.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Janë të mbështetura proceset për trajtimin e ngacmimit seksual, bullizmit dhe formave të tjera të ngacmimit.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Janë të mbështetura proceset e qarta, të shkruara lidhur me trajtimin e ngacmimeve në internet dhe digjitale dhe abuzimit .

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Janë të mbështetura proceset e qarta, të shkruara lidhur me aktet e dhunës.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Drejtnesit e lartë të partisë i trajtojnë personelin, anëtarët dhe vullnetarët në partinë time me profesionalizëm dhe dinjitet.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Ekzistojnë mundësi të barabarta për avancimi brenda partisë sime midis grave dhe burrave, ose si kandidatë ose si personel i partisë, pavarësisht nga mosha.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Ekzistojnë procese dhe forume të brendshme që merren me mosmarrëveshjet.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Në përgjithësi, të gjitha vendimet brenda partisë sime merren në mënyrë transparente.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Në përgjithësi, vendimet komunikohen në mënyrë të qartë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime respekton partitë politike kundërshtare.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime respekton organizatat e shoqërisë civile dhe mediat.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime vlerëson kontributin e organizatave të shoqërisë civile në çështjet e politikave që ndikojnë tek qytetarët.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime përfshin propozime të politikave nga organizatat e shoqërisë civile në platforma/manifesto.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

## Reagimi ndaj sjelljes së pahijshme

Partia ime ka udhëzime me shkrim lidhur me pakënaqësitë dhe ankesat.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Pakënaqësitë ose proceset e ankesave janë të përmbajtura dhe zgjidhen në mënyrë transparente

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Anëtarët e partisë, zyrtarët e zgjedhur, udhëheqësit dhe personeli që raportojnë abuzim ose veprime joetike trajtohen në mënyrë të drejtë, pa dënim ose hakmarrje.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Unë mund të mos pajtohem dhe të sfidojë në mënyrë konstruktive vendimet e marra nga udhëheqësit e lartë të partisë pa pasur frikë nga ndëshkimi.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

### Sjellja e udhëheqësisë

Zyrtarët e lartë të partisë angazhohen në veprime që konsiderohen të dobishme për partinë time dhe jo për interesin e tyre vetanak.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Zyrtarët e lartë në partinë time, prapa skenave, veprojnë në mënyrën që përputhet me besimet dhe standardet e partisë që janë të deklaruara publikisht.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Udhëheqësit e lartë të partisë janë të gatshëm të sfidohen në mënyrë konstruktive dhe të përfshihen në dialog.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Udhëheqësit e lartë të partisë janë përgjegjës për vendimet e tyre para një komiteti ekzekutiv apo organi të ngjashëm të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Lideri i partisë sime i drejton ato në mënyrë etike dhe në përputhje me kodin e sjelljes së partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Anëtarët e tjerë të kryesisë së lartë të partisë sime sillen në mënyrë etike dhe në përputhje me kodin e sjelljes së partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Drejtuesit e lartë të partisë trajtojnë personelin dhe vullnetarët me respekt.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

## KULTURA ORGANIZATIVE

Shkalla e integritetit	Kërkohen reforma të integritetit	Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme	Integriteti prezent	Niveli i lartë i integritetit
Rezultati i përgjithshëm	0-64	65-90	91-109	110-128

**Partia ime morri \_\_\_\_\_ në shkallën e integritetit për Kulturën organizative.**

### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.

### 3. VETINGU I KANDIDATËVE DHE PËRZGJEDHJA



Partitë politike janë rojet e portës për atë se kush do të kandidohet për zyrë, kush do të flet në emër të partive dhe kush përfaqëson interesat e qytetarëve në organet legjislativë. Sidoqoftë, në mbarë botën, votuesit kanë një marrëdhënie të pakëndshme me partitë politike dhe kandidatët, të cilët shpesh, zakonisht gjatë kohës së zgjedhjeve, japin premtime madhështore që votuesit i hedhin poshtë si jorealiste. Qytetarët gjithnjë e më shumë i perceptojnë partitë si klube të drejtuara nga elita me rregulla ndaluese të hyrjes dhe pjesëmarrjes; duke mos reaguuar ndaj qytetarisë më të gjerë; të papërkushtuar ndaj transparencës dhe llogaridhënies; dhe jo të gatshëm për të përfshirë dhe fuqizuar gratë dhe bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar brenda strukturave të tyre. Për më tepër, çështjet e korrupsionit, mosndëshkimit dhe vetë-interesit dëmtojnë më tej besimin e publikut në partitë politike dhe kandidatët e tyre. Sidoqoftë, nëse një parti është ka qytetarin në fokus, është gjithëpërfshirëse, etike, transparente dhe e përgjegjshme, ajo mund të tërheq kandidatë që shfaqin karakteristika pozitive që legjitimojnë partinë dhe rrisin besimin e publikut në politikë më gjerësisht.

Në shumë shtete, legjislacioni ose rregullat e zgjedhjeve përcaktojnë standardet minimale dhe kualifikimet për kandidatët. Për shembull, rregulloret formale përcaktojnë moshën minimale për kandidim, dhe nëse kandidatët duhet të jenë shtetas ose banorë të zonës zgjedhore në të cilën po kandidohen. Në shumë sisteme zgjedhore, rregulloret i ndalojnë individët për tu kandiduar për zyrë nëse kanë dënime për vepra penale ose financiare. Aty ku ekzistojnë kuota gjinore me ligj, partitë duhet të zgjedhin numrin minimal të grave dhe burrave që kandidohen për pozitë.

Por rregulloret formale ligjore nuk janë mjetet e vetme në dispozicion të partive politike kur bëhet përzgjedhja e kandidatëve. **Një element kritik i rindërtimit të besimit në partitë politike përfshin forcimin e mekanizmave të brendshme për veting dhe për përzgjedhje të kandidatëve për të identifikuar dhe zgjedhur kandidatë me cilësi të lartë, të cilët mund bëjnë çmos për transparencë dhe integritet, dhe sinqerisht të përfaqësojnë qytetarët që ata kërkojnë t'u shërbejnë. Për ta bërë këtë në mënyrë efektive, organet e partisë politike që bëjnë veting dhe përzgjedhin kandidatët duhet të jenë të pavarura, të bazuara në vlera, gjithëpërfshirëse dhe të demonstrojnë nivele të larta të integritetit.**

Prandaj, kjo pjesë përqendrohet në mënyrën sesi partitë politike zgjedhin se kush do t'i përfaqësojë ata si fytyrë e organizatës gjatë zgjedhjeve. Shqyrtojnë nëse dhe cilat standarde etike kandidatët e mundshëm duhet të plotësojnë për t'u konsideruar dhe kush është i përfshirë në përzgjedhjen e kandidatëve. Kjo pjesë gjithashtu konsideron koston e kandidaturës dhe nëse partitë bëjnë përpjekje për mundësi të barabarta në terrenin financiar.

#### Vetingu i kandidatëve

Rregullat e partisë duhet të sqarojnë standardet etike për kandidatët e mundshëm për pozitat publike. Në mënyrë ideale, partia duhet të artikulojë një proces për vetingun dhe standardet në dokumentet e shkruara të partisë, siç janë aktet nënligjore ose statutet. Këto standarde duhet të tejkalojnë kërkesat ligjore për të pasqyruar vlerat dhe prioritetet e partive që tregojnë një përkushtim ndaj integritetit. Kriteret e qarta (p.sh., në një listë) do të siguronin që zyrtarët e partisë të zbatojnë në mënyrë të barabartë rregullat dhe standardet kur bëjnë verifikimin e kandidatëve.


**Në minimum, partitë duhet të verifikojnë kandidatët potencial për vepra kriminale, keqpërdorime financiare, incidente të sjelljes së dhunshme dhe konflikteve të interesit. Për më tepër, partitë që dëshirojnë të demonstrojnë tolerancën dhe integritetin duhet të bëjnë kontrollin për shprehje ose vepra diskriminimi dhe sjellje që janë në kundërshtim me vlerat ose ideologjinë e partisë.**

Procesi i vetingut për pozita zyrtare të brendshme ose të jashtme partiake mund të marrë shumë forma, duke përfshirë intervista me kandidatët e mundshëm si dhe miqtë dhe bashkëpunëtorët. Kontrollat dhe kërkimet e regjistrave publik do të japin shenjë për çfarëdolloj detyrimesh ligjore ose financiare. Kërkimet dhe rishikimet e deklaratave publike, përfshirë ato në mediat sociale, ndihmojnë për të kuptuar vlerat dhe pikëpamjet e një personi. Më në fund, duke kërkuar nga kandidatët të nënshkruajnë kodin e sjelljes që është detyrueshëm, i sinjalizon kandidatit, dhe votuesve, se partia është e përkushtuar për përfaqësimin e standardeve më të larta.

Një proces i rreptë i vetingut kërkon kohë dhe personel. Për t'iu shmangur ngarkimit të zyrtarëve të partisë gjatë periudhës së ngarkuar parazgjedhore, partitë mund të krijojnë dhe verifikojnë një grup kandidatësh të mundshëm midis zgjedhjeve. Nëse një parti konstaton se kandidatët e mundshëm nuk i plotësojnë standardet minimale për integritet politik, ajo duhet të identifikojë dhe zgjedhë kandidatët e tjerë të mundshëm që i plotësojnë. Ndërsa vetingut i kandidatëve është vetëm një hap në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, ai është një hap thelbësor në forcimin e integritetit të një partie, dhe ndihmon në udhëheqjen dhe informimin e partisë që përfundimisht të zgjedhë individët më të mirë për ta përfaqësuar partinë gjatë dhe pas zgjedhjeve.

## Nënshtrimi verifikim të kandidatëve në El Salvador dhe Kosta Rika

Në El Salvador, komisioni kombëtar zgjedhor partiak i Aleancës nacionaliste republikane (ARENA) lëshon udhëzime që shpjegojnë kërkesat për regjistrimin e kandidatëve. Kërkesat përfshijnë letra rekomandimi nga organet lokale ose sektoriale të partisë; një deklaratë e betuar që vërteton vërtetësinë e informacionit të dhënë për kandidatin dhe një deklaratë zotimi ndaj kushtetutës së partisë, e cila përfshin kërkesa të tilla si një periudhë minimale të anëtarësimit, arsimimi dhe morali i dukshëm dhe një histori jete që është kryesisht në përputhje me ideologjinë e partisë.<sup>16</sup> Në Kosta Rika, Partia e qytetarëve për veprim (PAC) kërkon që para emërimit të tyre nga Kuvendi kombëtar i partisë, nga kandidatët e ardhshëm kërkohet të marrin pjesë në një kurs trajnimi politik që kulmon me një vlerësim, i cili merret parasysh në vendimin e emërimit.<sup>17</sup>



**Komisioni i emërimit të një partie—ose një organ i ngjashëm**—është një tipar i rëndësishëm në këtë proces. Komisioni ose organi **duhet të përfshijë një prerje tërthore të partisë** (p.sh., përfaqësuesit e krahut të grave dhe të rinjve) **që janë të pavarur nga presioni i udhëheqësve të partisë dhe të cilëve u jepet mundësi dhe ndikim i mjaftueshëm për të rekomanduar kandidatët për poste. Komisionet ose organet e tilla duhet të kenë burime të përshtatshme financiare dhe kapacitet njerëzor.**

## **Përzgjedhja e kandidatëve**

Partitë janë të ndikuara dhe udhëhequra nga disa faktorë gjatë përzgjedhjes së kandidatëve, duke përfshirë edhe sistemin zgjedhor, ligjet e jashtme, kulturën politike lokale, rregullat e brendshme, ideologjinë, dhe perspektivën për zgjedhje të kaluar dhe të ardhshme. Dy faktorë të rëndësishëm, nën kontrollin e një partie, ndikojnë në integritetin e një partie politike në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. E para është niveli i përfshirjes së organit ose organeve përgjegjëse për përzgjedhjen e kandidatëve, dhe i dyti është niveli i centralizimit të procesit të vendimmarrjes për përzgjedhjen.

Të dy faktorët janë disi të lidhur. Një proces shumë i centralizuar zakonisht nënkupton që më pak njerëz marrin pjesë në përzgjedhjen e kandidatëve. Nëse udhëheqësi i partisë, në nivel kombëtar, është përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve, ka hapësirë të kufizuar politike për pjesëmarrje më të gjerë në procesin e përzgjedhjes. Natyra demokratike dhe integriteti i partisë rrezikohen nëse udhëheqësi i partisë është individ i vetëm që zgjedh kandidatët edhe kur ato rekomandohen ose emërohen nga organet kombëtare ose lokale të partisë. Angazhimi i më shumë anëtarëve, veçanërisht në strukturat e partive në nivelin e degëve, në përzgjedhjen e kandidatëve, inkurajon pjesëmarrjen aktive në parti dhe promovon një rritje konkurruese, demokratike.

Krahu i grave dhe i të rinjve mund të luajnë një rol vendimtar në emërimin dhe sugjerimin e kandidatëve nga radhët e tyre.

Ekzistojnë disa arsye për të inkurajuar proceset e ndershme dhe demokratike në përzgjedhjen e kandidatëve brenda partive politike. Partitë politike që angazhohen në procese demokratike (jo vetëm për përzgjedhjen e kandidatëve) krijojnë mundësi që qytetarët t'i perceptojnë ata si demokratikë dhe gjithëpërfshirës në qeveri. Kandidatët aspirues kanë më shumë të ngjarë të jenë të interesuar të marrin pjesë në procese të ndershme dhe transparente ku kanë shansë, duke rritur gjasat që partitë politike të tërheqin një kalibër më të lartë të kandidatëve. Për më tepër, kur aktivistët dhe anëtarët janë të përfshirë në procesin e përzgjedhjes dhe kanë një rol në zgjedhjen e kush i përfaqëson ata, ata investohen në promovimin dhe fushatën për kandidatët.

Se si partitë politike bëjnë përzgjedhjen e kandidatëve duhet të jetë e shkruar në dokumentet e partisë të cilat janë në dispozicion të të gjithëve. Njëri nga qëllimet e proceseve të qarta, transparente dhe konkurruese për përzgjedhjen e kandidatëve është të zvogëlojë mundësinë e zgjedhjes së kandidatëve etikisht të papërshtatshëm.<sup>18</sup> Mungesa e rregullave të shkruara rrezikon që përzgjedhja e kandidatëve t'i nënshtrohet tekave dhe preferencave të udhëheqësve të partive, duke rrezikuar favorizimin pavarësisht gjetjeve ose rekomandimeve nga procesi i verifikimit. Një tjetër arsye për të pasur procese të qarta dhe të shkruara është që partia të mund të identifikojë fushat për përmirësim dhe reforma. Një ekzaminim i përzgjedhjes së kandidatëve brenda një partie mund të lokalizojë pabarazitë për mundësi të barabarta dhe mangësitë në tërheqjen e kandidatëve të kalibrit të lartë që pasqyrojnë bashkësinë.

## Kostoja e të qënit kandidat

Popullsitë jo-elitare dhe të bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar (p.sh., gra, të rinj, persona me aftësi të kufizuara, anëtarë të bashkësisë LGBTQI+, dhe pakica etnike, fetare dhe të dukshme) janë veç më dukshëm të nënpërfaqësuar në politikën formale, ndërsa çmimi gjithnjë në rritje e sipër për të garuar në zgjedhje po krijon pengesa gjithnjë e më të larta dhe më të pashpirta.

Kostoja e politikës ka implikime për cilësinë e përfaqësimit që çdo parti politike mund ta ofrojë, si dhe aftësinë e partisë për të zgjidhur probleme komplekse sociale dhe ekonomike pasi të zgjidhen në detyrë. Politika me kosto të lartë ka tendencë të krijojë një sistem pa merita në të cilin ata që përfundojnë post publik janë ata që mund të përballojnë çmimin e arritjes atje, në vend se të atyre që do të bënin punën më të mirë dhe ndonjëherë i kuptojnë më mirë problemet reale me të cilat përballen qytetarët e ndryshëm.

Mangësia më e dukshme nga rritja e kostos së politikës është mungesa e grave dhe përfaqësuesve të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar, të cilët kanë më pak të ngjarë të kenë qasje në nivelet e kërkuara të pasurisë së disponueshme personale, lidhjeve partiake ose rrjeteve të donatorëve me vlerë të lartë. Siç u përmend më lart, kjo jo vetëm që minon parimet e barazisë dhe drejtësisë që janë themelore për sistemet demokratike, por ajo privon shoqërinë nga standardet më të larta të qeverisjes dhe rezultate më të mira të politikave. Partitë që kërkojnë nga kandidatët e mundshëm të paguajnë për tu marrë në konsideratë, ose që nuk e kufizojnë shpenzimin në konkurrencë për t'u zgjedhur, kufizojnë aftësinë e tyre për të tërhequr më të mirin. Individët që mund të blejnë kandidaturën e tyre me paratë e tyre ose me donacione private, në vend se t'i meritojnë ato, zakonisht janë besnikë ndaj vetëm një entiteti: vetes së tyre ose financuesit të tyre e jo partisë.

Në vlerësimin e procesit të vetingut dhe përzgjedhjes së kandidatit të partisë, avokatët e integritetit partiak duhet të ekzaminonjë procesin e partisë, duke përfshirë pabarazinë dhe disavantazhet e mundshme me të cilat përballen bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar, dhe deri në ç'masë anëtarët e partisë jashtë udhëheqësisë së lartë janë të përfshirë në proces.



## PYETJET PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT



### VETINGU I KANDIDATËVE DHE PËRZGJEDHJA

#### Vetingu i kandidatëve

Rregullat e shkruara të partisë tregojnë qartë se cili organ i partisë është përgjegjës për verifikimin (vetingun) e kandidatëve dhe procesin dhe procedurat që ky organ ndjek.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka kriteret të qarta dhe specifike, të shkruara në rregullat e partisë, që parandalojnë individët që kanë dënime penale të kaluara apo të tanishme të konkurrojnë si kandidat.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka kriteret të qarta dhe specifike, të shkruara në rregullat e partisë, që parandalojnë individët keqpërdorime financiare të kaluara apo të tanishme të konkurrojnë si kandidat.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka kriteret të qarta dhe specifike, të shkruara në rregullat e partisë, që parandalojnë individët që kanë konflikt të interesit të konkurrojnë si kandidat.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka kriteret të qarta dhe specifike, të shkruara në rregullat e partisë, që parandalojnë individët me shprehje ose akte të diskriminimit të kaluara apo të tanishme të konkurrojnë si kandidat.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime zhvillon rregullisht kontrolle verifikimi për kandidatët para se të marrin zyrtarisht miratimin e partisë ose të lejohen të regjistrohen si kandidatë për zgjedhje

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Rregullat e partisë sime tregojnë qartë se çfarë dokumentacioni dhe informacioni tjetër xduhet të paraqesin për konsideratë kandidatët e mundshëm

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

## Përzgjedhja e kandidatëve

Rezultatet dhe rekomandimet nga vetingu i kandidatit ndikojnë në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve të partisë time.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për pozitë publike është i definuar qartë në dokumentet e shkruara.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Gratë dhe burrat konsiderohen të barabartë si kandidatë, pa dallim të moshës, etnisë, fesë, orientimit seksual apo ndonjë statusi tjetër të dukshëm të pakicës.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për pozitë publike përfshin edhe kontribut nga ana e anëtarëve jo ekzekutiv.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për pozitë publike përfshin kontribut nga ana e anëtarëve në nivel të degëve.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Në një kontekst të përfaqësimit proporcional, partia ime zbaton politikën e kuotave që vendos gratë lartë në listat e tyre të kandidatëve për pozitë publike. (Kaloje nëse vendi juaj ka një sistem *first-past-the-post* ku kandidati me më shumë vota fiton pa dallim nga përqindja)

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Në kontekst të sistemit *first-past-the-post*, partia ime zgjedhë gratë për t'u kandiduar në zona zgjedhore konkurruese. (Kaloje në qoftë se vendi juaj ka një sistem përfaqësimi proporcional).

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime zgjedhë të rinjtë për t'u kandiduar në zona konkurruese.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Përzgjedhja e kandidatëve vendos prioritet mbi diversitetin dhe përfshirjen e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar dhe përpiqet që të krijojë një listë përfaqësuese të popullit.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

### Kostoja e të qenit kandidat

Nga kandidatët potencial nuk kërkohet që të paguajnë kuotë anëtarësie apo kontribut për partinë time për aë se janë të konsideruar si kandidat.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Pasi që të jenë të zgjedhur, kandidatët e partisë mund të presin mbështetje dhe resurse financiare nga partia ime për fushatën zgjedhore.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Resurset për fushatë dhe mbështetje financiare janë të ndara në mënyrë të barabartë midis kandidatëve gra dhe burra.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Resurset për fushatë dhe mbështetje financiare janë të ndara në mënyrë të barabartë midis kandidatëve më të moshuar dhe më të ri (p.sh. ata 18-35 vjeçar).

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

## VETINGU I KANDIDATËVE DHE PËRZGJEDHJA

Shkalla e integritetit	Kërkohen reforma të integritetit	Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme	Integriteti prezent	Niveli i lartë i integritetit
Rezultati i përgjithshëm	0-38	39-53	54-64	65-76

**Partia ime morri \_\_\_\_\_ në shkallën e integritetit për Vetingun e kandidatëve dhe përzgjedhjen.**

#### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.

## 4. DIVERSITETI, BARAZIA DHE PËRFSHIRJA E BASHKËSIVE HISTORIKISHT TË NËNPËRFAQËSUARA<sup>19</sup>



Shumë parti zhvillojnë kultura të brendshme që dekurajojnë angazhimin nga aktivistë të rinj (siç janë gratë, gratë e reja dhe burrat e rinj, dhe bashkësi të tjera historikisht të nënpërfaqësuar) duke u mbrojtur dhe duke u mbështetur në procedurat dhe praktikën e vjetruara dhe rritet e personalizuara ndaj të cilave të gjithë të tjerët duhet të referojnë/përshtaten, të cilat shpesh pasqyrojnë normat gjinore mashkullore dhe të cilat hedhin poshtë idetë dhe inovacionet e reja. Kjo kulturë e brendshme e partisë parandalon pjesëmarrjen kuptimplote e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar, gjë që pengon larminë e mendimeve dhe përvojës. Përfshirja domethënëse jo vetëm që është një element thelbësor i proceseve demokratike, përfaqësimit dhe integritetit politik, por diversiteti i rritur gjithashtu kontribuon për parti të shëndetshme dhe më të suksesshme. Për më tepër, udhëheqja politike e grave siguron përparim në fushat e politikave që janë jetike për rritjen ekonomike dhe cilësinë e përmirësuar të jetës<sup>2021</sup> —mundësi që lihen pas, kur partitë politike nuk i japin përparësi roleve të vërteta të grave.

Prandaj, kjo pjesë, fokusohet në atë se deri në ç'masë partitë politike përfshijnë bashkësitë historikisht të nënpërfaqësura. Shikon përtej kandidatëve për të vlerësuar pjesëmarrjen kuptimplote dhe të barabartë të grave në strukturat e brendshme dhe proceset e vendimmarrjes. Kjo pjesë gjithashtu shqyrton atë se si partitë politike sigurojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupeve dhe bashkësive të nënpërfaqësuar.

### Barazia gjinore

Partitë politike kanë një rol thelbësor në promovimin dhe ruajtjen e pjesëmarrjes së barabartë të grave në jetën publike. Megjithatë nuk janë pakicë për nga numri, por pjesëmarrja e grave në politikë mbetet kryesisht e jo barabartë me atë të burrave, ndërsa ngelin pengesat institucionale, socio-kulturore dhe individuale për të hyrë dhe qëndruar në jetën politike. Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në politikë dhe në nivelet e larta të partive politike. Nënperfaqësimi i grave krijon një shoqëri pa status politik dhe ka ndikime negative mbi partitë politike. Kur gratë nuk marrin pjesë në mënyrë të barabartë në hartimin e politikave dhe sjelljen e vendimeve strategjike, partitë kanë kredibilitet të kufizuar në sytë e qytetarëve. Barazia gjinore nuk do të ndodhë rastësisht; kjo kërkon strategji dhe udhëheqësi të qëllimshme për të siguruar që gratë të jenë partnere të barabarta si në jetën publike ashtu edhe në atë private.

Pjesëmarrja e grave bën që partitë të përfitojnë drejtpërdrejt dhe mund të çojë në përmirësime të performancës së tyre në zgjedhje dhe rritje të forcës në përgjithësi. Për shembull, pas zbatimit të një kuote për gratë kandidate në nivelin lokal në Spanjë, të gjitha partitë politike rritën numrin e grave që garonin nën flamurin e tyre. Megjithatë, partitë që patën rritje më të konsiderueshme në gra kandidate gjithashtu patën një shfaqje shumë më të fortë se sa partitë e tjera për sa i përket rritjes së pjesës së tyre të votave më shumë sesa partitë e tjera në vendet e njëjta.<sup>22</sup>

Por, përfaqësimi i barabartë kuptimplotë i grave në politikë nuk ka të bëjë vetëm me numrin e grave kandidate që partitë i paraqesin në kohën e zgjedhjeve. Kandidatët dhe zyrtarët e zgjedhur janë megjithatë, shprehja më e dukshme dhe publike e zotimit të një partie për barazi gjinore. Angazhimi më transformues për të siguruar barazinë shkon përtej zgjedhjes së kandidatëve. Ai kërkon barazi

gjinore brenda strukturave të brendshme të partisë, duke përfshirë ku dhe si partia merr vendime, si hartohen dhe zbatohen propozimet e politikave me ndjeshmëri gjinore dhe alokimi i burimeve.

## Promovimi i përfshirjes gjinore në Afrikën e Jugut

Në Afrikën jugore, Lidhja e Grave (ANCWL) e Kongresit Kombëtar Afrikan (ANC) ishte e përfshirë në pozita kyçe udhëheqëse në transformimin e hershëm të vendit dhe të partisë në vitet 1990ta. Kjo ngritje e hershme e grave në pozita kyçe ndihmoi në sigurimin që gratë aktiviste të ANC të kishin një vend në tryezë, të cilin ato e përdorën për të institucionalizuar një kornizë të barazisë gjinore përmes dokumenteve të rëndësishme të partisë. Përpjekjet e forta për avokim—duke përfshirë edhe përdorimin e presionit ndërkombëtar në anën e grave aktiviste të partisë bënë që ANC të krijojë disa mekanizma dhe politika vullnetare (p.sh., një rritje në sistemin e kuotave nga 30% në 50% në vitin 2004) për të siguruar përfaqësimin e grave në politikën e Afrikës jugore. ANCWL është me ndikim jo vetëm në bazë të numrit të tyre në parlament. Ato mbajnë poste pothuajse në çdo nivel të qeverisjes dhe kanë mbajtur poste të nënkryetares, ministreve, kryetare parlamenti dhe koordinatorë në parlament. Gratë gjithashtu po përfaqësohen gjithmonë e më shumë në strukturat komunale dhe këshillat.<sup>23</sup>



Mënyra e vetme për të arritur barazinë gjinore në politikë dhe qeverisje është që partitë politike të marrin seriozisht barazinë gjinore dhe duke i promovuar gratë në mënyrë aktive si vendimmarrëse me ndikim brenda të gjitha niveleve të organizatave të tyre. Meqenëse strukturat e brendshme drejtohen nga rregulla formale dhe ndikohen nga kultura organizative joformale, partitë politike duhet të ekzaminojnë si rregullat ashtu dhe kulturën kur bëjnë vlerësimin e barrierave të cilat përjashtojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave.

### Diversiteti, barazia dhe përfshirja

Të qenit përfshirës nuk do të thotë vetëm të sigurohet pjesëmarrja e barabartë e grave. Do të thotë gjithashtu të sigurohet përfshirja e grupeve të tjera të nënpërfaqësuar, si të rinjtë, pakicat etnike/fetare, bashkësia LGBTQI+ dhe personat me aftësi të kufizuara. Nëse partitë politike nuk pasqyrojnë elektoratin të cilin dëshirojnë ta tërheqin, atëherë atyre u mungon kredibiliteti për të folur dhe vepruar në emër të atij elektorati. Shoqëritë po bëhen gjithnjë e më të shumëllojshme, duke kërkuar nga partitë politike që të zhvillojnë politika të jashtme dhe të brendshme që pasqyrojnë shqetësimet e bashkësive të nënpërfaqësuar.

Përfshirja dhe barazia e një larmie zërash dhe mendimesh në zhvillimin e prioriteteve të partive politike, duke përfshirë politikën, forcon shanset e një partie për sukses. Shumica e partive të suksesshme në proceset kanë një gjë të përbashkët: mbështetje të gjerë nga bashkësitë e ndryshme të investuara në suksesin e partive. Partitë me procese përfshirëse të bërjes së politikave dhe vendimmarrjes gëzojnë mbështetjen e aktivistëve besnikë, që janë të gatshëm të punojnë shumë për të bërë partinë fitimtare. Organizatat që krijojnë një mjedis të hapur dhe mikpritës janë më të qëndrueshme dhe tërheqëse për votuesit.

Pyetjet e vlerësimit këtu nuk janë gjithëpërfshirëse për përfshirjen e grave dhe bashkësive të tjera historikisht të nënpërfaqësuara. Partitë politike që marrin seriozisht përfshirjen dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave shpesh herë kryejnë revizione ose vlerësime të pavarura dhe të thella gjinore. Këto procese vlerësojnë perceptimet që gratë dhe burrat kanë ndaj grave në udhëheqësi, llojet e normave shoqërore të cilat i kanë anëtarët e partive politike dhe shoqëria, si dhe barrierat individuale, institucionale dhe socio-kulturore që ekzistojnë për të parandaluar arritjen e plotë të barazisë gjinore.

Pyetjet e mëposhtme të vlerësimit do të ndihmojnë për të kuptuar se cilat janë pengesat për përfshirjen e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuara dhe si të trajtohen ato.

## PYETJET PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT



### DIVERSITETI, BARAZIA DHE PËRFSHIRJA E BASHKËSIVE HISTORIKISHT TË NËNPËRFAQËSUARA

Partia ime ofron trajnime dhe resurse anti-diskriminuese për anëtarët e partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Kultura organizative e partisë sime aktivisht inkurajon pjesëmarrje më të madhe dhe udhëheqësi nga bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuara.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime ka një komision për partet gjinor, jashtë krahut formal të grave, që këshillon lidhur me çështjet e brendshme të barazisë gjinore brenda partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime prodhon dhe shpërndan materiale në gjuhët jo dominuese.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime prodhon dhe shpërndan materiale në gjuhën *braille*, përkthime tekst-në-zë, ose resurse të ngjashme për ata që kanë të pamurit e dëmtuar.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime përdorë përkthyes në gjuhën e shenjave gjatë ngjarjeve publike.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime zgjedh lokacione të përshtatshme për karrocë invalidi gjatë organizimit të ngjarjeve publike.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime siguron përfshirjen e grave dhe anëtarëve të rinjë në takime të brendshme dhe të jashtme duke i organizuar ato në kohë që janë të përshtatshme për ta.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Krahu i grave të partisë sime është i përfaqësuar në mënyrë të shprehur në strukturat udhëheqëse të partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Krahu rinor i partisë sime është i përfaqësuar në mënyrë të shprehur në strukturat udhëheqëse të partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Krahu i grave të partisë sime ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore të cilat kontrollohen në mënyrë të pavarur nga krahu.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Krahu rinor i partisë sime ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore të cilat kontrollohen në mënyrë të pavarur nga krahu.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Krahu i grave të partisë sime konsiderohet si organ me ndikim ose i rëndësishëm brenda partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Krahu rinor i partisë sime konsiderohet si organ me ndikim ose i rëndësishëm brenda partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Kodi i sjelljes i partisë sime ndalon të gjitha format e dhunës ndaj bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar brenda dhe jashtë partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4



Partia ime ka një mekanizëm të qartë raportimi për dhunën ndaj bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar që mbron viktimat dhe jep ndëshkimin e duhur për shkelësit.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Rekrutimi i anëtarësisë i partisë sime përfshin një qasje aktive ndaj bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Zhvillimi i politikave të partisë sime përfshin kontribut nga gratë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Zhvillimi i politikave të partisë sime përfshin kontribut nga të rinjtë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Zhvillimi i politikave të partisë sime përfshin kontribut nga personat me aftësi të kufizuara.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Zhvillimi i politikave të partisë sime përfshin kontribut nga pakicat etnike dhe fetare.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Zhvillimi i politikave të partisë sime përfshin kontribut nga bashkësia LGBTQI+.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime ka politika pro-rinore si pjesë e platformës politike së jashtme të saj të politikave të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka politika pro-grave si pjesë e platformës politike të saj të politikave të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka politika për qasje të personave me aftësi të kufizuara si pjesë e platformës së saj të politikës së jashtme.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka politika për mosdiskriminim etnik dhe fetar si pjesë e platformës politike të saj të politikave të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka politika pro LGBTQI+ si pjesë e platformës politike të saj të politikave të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

## DIVERSITETI, BARAZIA DHE PËRFSHIRJA E BASHKËSIVE HISTORIKISHT TË NËNPËRFAQËSUARA

Shkalla e integritetit	Kërkohen reforma të integritetit	Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme	Integriteti prezent	Niveli i lartë i integritetit
Rezultati i përgjithshëm	0-56	57-79	80-95	96-112

**Partia ime morri \_\_\_\_\_ në shkallën e integritetit për Diversitet, barazi dhe përfshirje të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar.**

### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.

## 5. MBLEDHJA E FONDEVE DHE MENAXHIMI FINANCIAR




Këndvështrimet cinike të cilat shumë qytetarë i kanë ndaj partive politike, si subjekte të korruptuara, burojnë nga skandalet e pafund që lidhen me politikën dhe paratë. Asnjë çështje nuk shkakton më shumë vështirësi për partitë politike, si nga pikëpamja organizative, ashtu edhe nga ajo strategjike, dhe si një sfidë e menaxhimit të marrëdhënieve me publikun. Partitë politike kanë nevojë për burime për të garuar në zgjedhje, për të funksionuar si organizata ndërmjet zgjedhjeve dhe për të investuar në zhvillim, rritje dhe mësim. Por mënyra se si partitë mbledhin dhe përdorin resurset përcakton nëse ato kontribuojnë pozitivisht në qeverisje të mirë apo veprojnë nën ndikimin e agjendave të jashtme, madje edhe atyre të fshehura. Me pak fjalë, si (dhe nga kush) partitë grumbullojnë dhe shpenzojnë fonde, dhe sa transparente janë në lidhje me financimin, përcakton nivelin e tyre të integritetit—ose mungesën e tij.

Rregullimi i financave politike është një mënyrë për të garantuar nivelet themelore të pavarësisë, transparencës dhe barazisë brenda sistemit të qeverisjes. Sidoqoftë, këto sisteme kërkojnë kohë dhe kërkojnë që vullneti politik dhe udhëheqja të jenë efektive. **Fatmirësisht, partitë politike nuk kanë nevojë të presin legjislacionin. Ekzistojnë praktika të brendshme që partitë mund t'i përvetësojnë, pa vonesë, për të nxitur marrëdhënie të ndershme me donatorët, financuesit dhe mbështetësit që manifestojnë nivelet më të larta të integritetit brenda dhe jashtë organizatës.** Për shembull, partia së pari duhet të konsiderojë se sa efektive janë praktikatat e saja të menaxhimit të brendshëm financiar dhe mbajtja e të dhënave dhe të bëjë përmirësime sipas nevojës, bazuar në gjetjet e vlerësimit të integritetit. Pasi që partia të ketë vendosur menaxhim efektiv financiar dhe praktika të mbajtjes së të dhënave, ajo duhet të gjejë mënyra për të përmirësuar zbulimin e donacioneve dhe donatorëve për të kontribuar në një transparencë më të gjerë financiare (shih figurën 2).

Keni parasysh se varësisht nga gjendja financiare e një partie dhe e mbajtjes së të dhënave në parti, reformimi i sistemeve dhe futja e proceseve më etike janë përpjekje afatgjate të cilat kërkojnë disiplinë dhe mbikëqyrje për t'u mirëmbajtur.

Prandaj, kjo pjesë, përqendrohet në aspektet e ndjeshme por thelbësore të integritetit të partive politike—se si ata mbledhin dhe harxhojnë para. Gjithashtu shqyrton nëse dhe si partitë raportojnë për kontributet dhe shpenzimet, dhe nëse shpenzimet gjatë fushatës janë etike dhe transparente. Më në fund, dhe në mënyrë thelbësore, kjo pjesë konsideron nëse partitë politike përdorin apo jo praktika të brendshme të menaxhimit financiar të cilat promovojnë integritetin.

**Figura 2: Shkalla e transparencës financiare të partisë politike**



## Standardet dhe kufizimet lidhur me fondet dhe donatorët

Jo çdo person ose entitet që dëshiron të kontribuojë në një parti politike edhe duhet të kontribuojë. Shumë shpesh, donatorët financiarë të partive politike presin fitime materiale ose shpërblime si këmbim ndaj kontributit të tyre, gjë që rrezikon integritetin e partisë. Shumë sisteme politike ndalojnë donacione nga organizata dhe individë, përfshirja e të cilëve në financimin e partive mund të dëmtojë, ose komprometoj, procesin demokratik. Shumë sisteme vendosin kufij mbi shumat e donacioneve që një parti politike mund të pranojë, një gjë që jo vetëm që zvogëlon nxitjen për përfitime të paligjshme, por inkurajon partitë politike të arrijnë tek shumë më shumë qytetarë për të kërkuar donacione më të vogla, duke ndërtuar kështu mbështetje nga votuesit e rëndomë.

## Menaxhimi i brendshëm financiar dhe mbajtja e të dhënave

Shumë parti hezitojnë të jenë publikisht transparente për financat e tyre sepse duke bërë kështu do të zbulonin praktika të dobëta të menaxhimit të brendshëm financiar, si dhe një infrastrukturë përgjithësisht të papërshtatshme organizative. Sidoqoftë, është thelbësore që partitë ti japin përparësi mbajtjes së saktë të të dhënave në sisteme ose procese të përgjegjshme për administrimin e fondeve partiake për të avancuar integritetin e organizatës. Procedurat e qarta për menaxhimin financiar kontribuojnë në llogaridhënien e brendshme partiake duke ndihmuar në sigurimin që fondet të përdoren vetëm për punët e aprovuara partiake. Partitë mund të përdorin statutet ose aktet e tyre nënligjore për të përshkruar përgjegjësitë e raportimit financiar dhe për të krijuar borde të brendshme për mbikëqyrje ose komisione që janë përgjegjëse për revizion të brendshëm të financave partiake. Procedurat për mbajtjen e të dhënave me shkrim të cilat janë të mbajtura nga personeli i përkushtuar dhe të rishikuara rregullisht, kjo u jep mundësi zyrtarëve të partisë të shohin se ku dhe si shpenzohen fondet dhe ndihmojnë në përgatitjen e partisë për detyrimet për llogaridhënie tek autoritetet përkatëse.

Partitë duhet të kenë procedura të fuqishme për regjistrimin e transaksioneve financiare që përfshijnë sisteme të brendshme të **kontrolleve dhe ekuilibrave** për të siguruar mbikëqyrje dhe kontroll. Një **komision i brendshëm për revizion ose financa** i cili është i pavarur nga udhëheqësia duhet të ketë qasje në të gjitha të dhënat e transaksioneve financiare, duke përfshirë shpenzimet e nivelit të degëve dhe të kandidatëve. Partitë duhet rregullisht të **angazhojnë revizorë të jashtëm dhe të pavarur** për të shqyrtuar të dhënat financiare të organizatës.

Duhet të ketë transparencë në lidhje me burimet e të ardhurave, mënyrën se si partia i harxhon paratë e saja dhe procesin e vendimmarrjes për shpenzimet. Partitë duhet të mbajnë **një sistem për të ndjekur dhe regjistruar** të gjitha të ardhurat dhe donacionet, duke përfshirë kontributet në natyrë ose ato materiale. **Politikat e prokurimit** duhet të sigurojnë që fondet e shpenzuara për shërbime të plotësojnë testin e meritës, konkurrencës dhe pavarësisë. Dokumentet e partisë duhet të përshkruajnë kriteret për dhënien e kontratave për shitësit, dhe një komision i brendshëm partiak duhet të jetë përgjegjës për shqyrtimin e ofertave dhe ekzekutimin e prokurimit.

Mungesa e procedurave gjithëpërfshirëse dhe transparente për administrimin e fondeve komprometon demokracinë dhe integritetin e brendshëm partiak, dhe, përfundimisht, administrimi i fondeve të partive bëhet i cenueshëm ndaj mashtimit.

## Shpalosje e donacioneve dhe donatorëve

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të siguruar transparencën e financave të partive politike dhe respektimin e rregulloreve për donacione. Disa sisteme kërkojnë raportim publik të donacioneve dhe të

donatorëve në intervale të rregullta. Në disa raste, partitë duhet vetëm të zbulojnë identitetin e donatorëve që japin mbi një shumë të caktuar. Të tjerët nuk i detyrojnë partitë të zbulojnë identitetin e donatorëve, por i detyrojnë partitë që të japin raporte përmblendhëse mbi të ardhurat dhe shpenzimet e tyre.

Në disa vende, partitë opozitare nuk kanë dëshirë të zbulojnë identitetin e donatorëve të cilët frikësohen nga ndëshkimi i autoriteteve në pushtet; partitë opozitare argumentojnë se aftësia e tyre për të mbledhur fonde zvogëlohet me rritjen e transparencës. Deri sa kjo, për fat të keq, është një realitet për shumë parti opozitare, ekzistojnë edhe parti të tilla me përkushtim për shpalosje financiare gjë që shërben si presion plotësues ndaj partive të tjera për të bërë të njëjtën gjë.

## Transparenca

Partitë politike që vullnetarisht ushtrojnë nivelet më të larta të mundshme të transparencës në mbledhjen e fondeve dhe shpenzimeve të tyre—pavarësisht nga kërkesat ligjore—kanë shumë më shumë gjasa të krijojnë një marrëdhënie me votuesit të bazuar në mirëbesim. Për të garantuar integritet maksimal, partitë politike duhet të mbajnë shënime të shëndosha dhe të mirëfillta financiare, të cilat shërbejnë për të gjeneruar mirëbesim, për të përmirësuar kredibilitetin dhe për të inkurajuar kontributet për financimin e aktiviteteve të partive. Qytetarët ka më shumë gjasa të dhurojnë nëse e dinë se partitë i përdorin paratë e tyre me përgjegjësi dhe në mënyrë të drejtë.<sup>24</sup> Transparenca e financave të partive politike është gjithashtu një vegël e vlefshme për ndërtimin e partive dhe për rekrutim. Të kuptuarit se si dhe për çfarë partia harxhon fonde është një nxitje e konsiderueshme për anëtarët e partisë për të promovuar partinë dhe për të marrë pjesë në përpjekjet e mbledhjes së fondeve.

## Zbulimi financiar dhe transparenca në Indi dhe në Spanjë

Pjesërisht për shkak të rinisë së anëtarëve të saj, Partia Aam Aadmi (AAP) në Indi ka përdorur në mënyrë të konsiderueshme teknologjinë për të përmirësuar shtrirjen dhe transparencën në menaxhimin e financave të partisë. Një tipar kryesor i përpjekjeve të AAP-së për transparencë më të madhe fiskale është qëllimi i tyre për të deklaruar publikisht të gjitha shpenzimet dhe rupitë e mbledhura me anë të donacioneve në faqen e internetit të partisë, duke përfshirë informacione mbi origjinën e donacionit, muajin dhe shumën, të azhurnuara në kohë reale. Sfida e AAP-së [#iFundHonestParty](#) (Unë financoj parti të sinqertë) u lejon përkrahësve të bëjnë donacion përmes një aplikacioni në celular, që i dërgon donatorit një faturë përmes SMS apo email-it dhe e poston kontributin në internet.<sup>25</sup> Në Spanjë në vitin 2014, Partia Socialiste Spanjolle (PSOE) nënshkroi një marrëveshje me Transparencën Ndërkombëtare Spanjë (Transparency International Spain -(TI-E)) për shpalosjen e dokumenteve financiare dhe dokumenteve të tjera të brendshme partiake, përmes TI-E duke promovuar transparencën e rritur të partisë.<sup>26</sup>



## **Blerja e votës dhe përdorimi i stimujve material për votuesit**

Blerja e votave është një fenomen i përhapur dhe një qark i lig për tu prishur. Për të eliminuar këtë praktikë në mënyrë efektive, të gjitha partitë duhet të përmbahen nga blerja e votave. Nëse vetëm një parti ose kandidat vazhdon me këtë traditë, votuesit—veçanërisht ata me të ardhura të ulëta dhe në nevojë—do të pranojnë me vullnet paratë dhe dhuratat. Por, megjithëse votuesit mund të jenë në nevojë, ata nuk janë naivë, ndërsa partitë të cilat shpërndajnë para ose dhurata komprometojnë integritetin e tyre në sytë e qytetarëve.

Ekziston një linjë e hollë që shpesh herë mjegullohet nga shpenzimet e ligjshme të fushatës. Për shembull, sigurimi i pijeve freskuese në ngjarjet e fushatës ose transportimi në qendrat e votimit mund të konsiderohen si blerje votash. Sidoqoftë, këto shembuj janë shpenzime të arsyeshme të fushatës në shumë demokraci. Kostot e shpenzimeve legjitime të fushatës duhet të deklarohen dhe të jenë transparente.

Partitë politike me një dedikim të mirëfilltë për integritet duhet të kenë rregulla të brendshme që ndalojnë blerjen e votave dhe në mënyrë të fuqishme të ndëshkojnë kandidatët që përdorin para ose dhurata për të tërhequr vota. Për të përforcuar këtë përkushtim, partitë mund të gjejnë aleatë në organizatat e shoqërisë civile që punojnë mbi çështjet e integritetit dhe transparencës gjatë zgjedhjeve. Partitë duhet të marrin timonin në promovimin e transparencës financiare, duke përfshirë refuzimin e blerjes së votave, për të ndërtuar dhe për të fituar besimin.

## PYETJET PËR VLERËSIM TË INTEGRITETIT



### MBLEDHJA E FONDEVE DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Partia ime ka kufizime të qarta në rregulloret e partisë për atë se kush mund dhe kush nuk mund të dhurojë, si plotësim i asaj që kërkohet me ligj.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ndalon kontributet nga organet ose institucionet publike.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ndalon kontributet nga entitete të huaja.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ndalon kontributet nga donatorë anonim.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ndalon kontributet nga korporatat me kontrata qeveritare.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime shpalos kontributet nga të gjitha korporatat.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ndalon donacione indirekte (kontribute të dhëna përmes një personi ose entiteti tjetër).

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ndalon përdorimin e burimeve shtetërore (përveç financimit publik për partitë) për qëllime partiake.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime kufizon se sa shumë mund të kontribuojnë donatorë individual.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime rregullisht publikon një listë të plotë të individëve dhe organizatave që dhurojnë fonde për partinë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime rregullisht bën deklarime të plota publike të shpenzimeve.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

Partia ime në mënyrë eksplicite ndalon blerjen e votave nga ana e zyrtarëve të partisë ose kandidatëve.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka një ekip të përkushtuar profesional që menaxhon financat e partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka udhëzime të shkruara ose politika për kontabilitetin financiar dhe mbajtjen e të dhënave.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka udhëzime ose politika të qarta se kush mund të marrë dhe të shpenzojë fonde në emër të partisë.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka një komision të brendshëm për mbikëqyrje financiare që është i pavarur nga udhëheqësia.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime rregullisht dërgon të dhënat financiare të organizatës tek një revizor i pavarur dhe i jashtëm për rishikim.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4



Partia ime ka politika të shkruara për prokurim.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Partia ime ka një komision të brendshëm për prokurim që shqyrton dhe mbikëqyr dhënien e kontratave për shitësit.

Nuk e di	Jo	Po
0	1	4

Procesi i menaxhimit financiar i partisë sime është i llogaridhënës dhe transparent për anëtarët e partisë.

Nuk e di	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
0	1	2	3	4

## MBLEDHJA E FONDEVE DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Shkalla e integritetit	Kërkohen reforma të integritetit	Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme	Integriteti prezent	Niveli i lartë i integritetit
Rezultati i përgjithshëm	0-40	41-56	57-68	69-80

**Partia ime morri \_\_\_\_\_ në shkallën e integritetit për Mbledhjen e fondeve dhe menaxhimin financiar.**

### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.



# UDHËZIM SE SI TË ZBATOHEN GJETJET NGA VLERËSIMI I INTEGRITETIT

Në qoftë se partia ka kryer një vlerësim të integritetit, ajo tashmë ka arritur një moment tejet të rëndësishëm. Duke rënë dakord për të shqyrtuar fushat e funksionimit të brendshëm në këtë mjet vlerësimi, udhëheqësia e partisë ka treguar një interes për rezultatet dhe një angazhim për të përmirësuar integritetin e partisë.

Pasi që partia të ketë mbledhur të gjitha përgjigjet e pyetjeve të vlerësimit të integritetit, ka gjasa të zbulojë mospërputhje midis përgjigjeve të individëve. Njerëz të ndryshëm kanë perceptime të ndryshme për atë se si funksionon partia dhe si zbaton dhe promovon çështjet që kanë të bëjnë me integritetin. Përmbledhja dhe sistemimi i të gjitha përgjigjeve në secilën kategori, do t'i lejojë partisë të vlerësojë mesataren nga totali dhe të zhvillojë një shkallë të përgjithshme të integritetit për secilën nga pesë kategoritë:



**Struktura  
organizative**



**Kultura  
organizative**



**Vetingu i  
kandidatëve dhe  
përzgjedhja**



**Përfshirje kuptimplote e  
grupeve të marginalizuara  
tradicionalisht**



**Mbledhja e fondeve dhe  
menaxhimi financiar**

Nëse partia ka arritur **nivelin më të lartë të integritetit** në një ose më shumë prej kategorive, atëherë ia vlen të pyesni pse dhe të ekzaminoni faktorët të cilët kontribuan për nivelin e lartë. Të kuptuarit se ku ka sukses partia në promovimin dhe zbatimin e integritetit do ta ndihmojë atë që të hartojë dhe zbatojë masa reformuese në fushat që kanë nevojë për përmirësim. Dy nivelet e integritetit që kërkojnë vëmendje dhe analizë do të jenë dy nivelet më të ulëta: integriteti i rrezikuar dhe kërkohet reforma e integritetit. **integriteti i rrezikuar** dhe **kërkohen reforma të integritetit**.

#### UDHËZIM PËR PARTITË POLITIKE:

- **Niveli i lartë i integritetit:** Nivel i lartë i integritetit politik.
- **Integriteti prezent:** Nivel i integritetit politik. Monitorim i praktikave për të mirëmbajtur apo përmirësuar integritetit politik.
- **Integriteti i rrezikuar! Vlerësim i praktikave të brendshme:** Nivel i kufizuar i integritetit politik. Vlerësim i praktikave dhe identifikim i fushave potenciale të reformave të integritetit.
- **Kërkohen reforma të integritetit:** Nivel i ultë i integritetit politik. Zhvillim dhe zbatim i strategjisë për të adresuar boshllëqet në integritet.

Nëse partia tregohet më mirë në shkallën e integritetit në një kategori se të tjerët, ky mund të jetë një vend i shkëlqyeshëm për të filluar. Përmirësimi i praktikave ose proceseve në parti ku ajo tashmë ka lëvizje do të bëjë më të mundshëm suksesin dhe do të krijojë një hov për trajtimin e çështjeve më të vështira aty ku partia ka shënuar nivel më të ulët në shkallën e integritetit.

Partia mund të zbulojë që, brenda një kategorie, ajo rezulton në nivel më lartë për disa çështje se sa të tjerët. Për shembull, mund të zbulojë se partia ka një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës për të zgjedhur kandidatët, por nuk angazhohet në asnjë formë të verifikimit (vetingut) të kandidatëve. Për të rritur shkallën e integritetit të partisë në këtë kategori, qëllimi i përgjithshëm duhet të jetë, pra, të rritet integriteti i verifikimit (vetingut) të kandidatëve.

Përfundimisht, **ekipi që mbikëqyr vlerësimin duhet të diskutojë dhe të analizojë rezultatet** në secilën sferë dhe të angazhohet për të ecur përpara me reformat e nevojshme. Nevoja për përmirësim thelbësor ndonjëherë mund të jetë e tepërt me një listë të pafund elementesh që kanë nevojë për ndryshime.

## Fillimi i bisedës me udhëheqësit e partisë

Duke rënë dakord për të shqyrtuar fushat e funksionimit të brendshëm në këtë mjet vlerësimi, udhëheqësia e partisë ka demonstruar një nivel interesi për rezultatet dhe për përmirësimin e integritetit të partisë. Pasi që ekipi i integritetit të kryejë vlerësimin, hapi tjetër është fillimi i bisedave me udhëheqësinë e partisë.

**Ekipi i vlerësimit duhet të informojë anëtarët e lartë të partisë për rezultatet e vlerësimit, duke shënuar se ku partia shënoi rezultate të larta dhe fushat për përmirësim.**

Si pjesë e këtyre bisedave, **ekipi i vlerësimit të integritetit duhet të zhvillojë një listë të fushave prioritare për reformë, të vlerësojë gatishmërinë e udhëheqësisë së partisë ose rezistencën për të reformuar dhe të zhvillojë një plan zbatimi** (shih Tabelën 4).

Si pjesë e këtij procesi, ekipet e vlerësimit të integritetit duhet të:

- Përcaktojnë se ku dhe mbi çfarë, ekipi i integritetit është i gatshëm të bëjë kompromis në mënyrë që të jetë i gatshëm të negociojë (shih “Arritja e kompromisit për reformën e integritetit” në këtë pjesë);
- Identifikoni aleatët dhe dëmtuesit për reformën (shih “Hartëzimi i energjisë” në këtë pjesë); dhe
- Zhvilloni strategji për zbutjen e rrezikut për të çuar përpara reformat e integritetit ku dhe kur është e mundur (shih Tabelën 4).

### **Nëse ekipi i vlerësimit të integritetit beson se udhëheqësia e partisë nuk do të jetë e gatshme për të ndryshuar, ekipi duhet të ndërmarrë hapa shtesë, duke përfshirë:**

- Angazhimin e anëtarëve të lartë për të kuptuar rreziqet dhe përfitimet e tyre të perceptuara për reformën e integritetit;
- Prioritizimi i fushave të integritetit për reformë që flasin për vlerat e partisë dhe përparësitë aktuale që mund të gjenerojnë mbështetje të udhëheqjes; dhe
- Rregullimi i planit të zbatimit për të marrë parasysh aktivitetet shtesë me udhëheqësinë dhe një ritëm afatgjatë për reformë.

Për më shumë informacion, merrni parasysh udhëzimet e ndryshme në këtë pjesë, si dhe udhëzimet e NDI Marrja e timonit dhe pilotimi i ndryshimeve: Një kornizë për reformatorët partiakë.

## **Prioritizimi i reformave të integritetit**

Nëse ekipi i integritetit në parti beson se udhëheqësia është e gatshme të përmirësojë integritetin duke u angazhuar në reforma, partia do të duhet të prioritzojë sferat për reformë dhe të planifikojë zbatimin e tyre. **Vendi i parë për të filluar është me udhëheqësinë e partisë.** Ekipi i vlerësimit duhet të informojë anëtarët e lartë të partisë për rezultatet e vlerësimit, duke theksuar se ku partia ka shënuar rezultate të larta dhe sferat për përmirësim.

Partia mund të zgjedhë të zhvillojë një punëtori me lehtësues ose një fokus grup me udhëheqësinë e partisë për të vlerësuar mbështetjen e tyre dhe për t'i angazhuar ata në përcaktimin e përparësive dhe sugjerimin e zgjidhjeve. Përfshirja e anëtarëve të lartë të partisë gjithashtu do të ndihmojë në të kuptuarit e fushave me “vijë të kuqe”—kufijtë ose limitet të cilët nuk duhet (ose nuk mund aktualisht) të kalohen. Meqenëse komunikimi ka të bëjë me dëgjimin aq sa ka të bëjë me bisedimin, partia do të fitojë njohuri se si të vazhdojë duke dëgjuar udhëheqësinë e partisë për rezultatet e vlerësimit.

Sferat më të dukshme për të përmirësuar integritetin janë ato që kanë mbështetjen e udhëheqësisë së partisë. **Trajtimi i reformave të integritetit për të cilat të gjithë pajtohen se janë të nevojshme do ti sigurojë partisë “fitore të shpejta” dhe dëshmi që partia mund të bëjë ndryshime.** Fitoret e shpejta gjithashtu do t'i japin partisë vetëbesimin për të vazhduar me reforma më të vështira në plan afatgjatë.

Përveç udhëheqësisë së partisë, partia mund të ndajë rezultatet dhe të kërkojë informata kthyesë nga grupet kryesore brenda partisë. **Përderisa vlerësimi do të tregojë se cila është shkalla e integritetit të partisë, ai nuk do të shpjegojë përse.** Nëse, për shembull, partia ka vlerësim të ulët në menaxhimin financiar, duhet të këshillohet me ekipin ose me zyrtarët e partisë të ngarkuar me menaxhimin e financave për të shqyrtuar se ku janë problemet dhe se si mund të zgjidhen. Mund të jetë po aq e thjeshtë sa mungesa e trajnimit ose mbikëqyrjes. Dëgjimi i grupeve të ndryshme brenda partisë

gjithashtu do të ndihmojë atë të identifikojë aleatët për të mbështetur reformën e integritetit. **Ekipi i integritetit në parti, gjithashtu duhet të informojë krahun e grave, krahun rinor dhe shoqatat e tjera të mundshme zyrtare brenda partisë (p.sh. komisioni ekzekutiv kombëtar, krahun LGBTQI+, etj.) për të kërkuar informata kthyesë dhe sugjerime për mënyra se si të përmirësohet integriteti. Arritja tek njerëzit më të prekur nga çështja e integritetit do të ndihmojë atë të prioritetizojë sferat për reforma dhe të rekrutojë përkrahës për përpjekjet e saja.**

## Të filluarit në udhëtimin drejt reformës së integritetit

Reformimi i një partie dhe zbatimi i **ndryshimit fillon me hapa të vegjël**. Gjithashtu fillon duke pasur një vizion për atë që patia dëshiron t'a ndryshojë, duke e ndarë atë vizion në pjesë të menaxhueshme dhe duke hartuar një plan për të zbatuar atë ndryshim.

**Planifikimi** është një proces i vazhdueshëm dhe gjithmonë në zhvillim, me komponentët e qenësishëm të një plani të fuqishëm siq janë fleksibiliteti dhe struktura. Një plan duhet të jetë në gjendje të përshtatet me ndryshimet e brendshme dhe të jashtme, ndërsa njëkohësisht të sigurojë një kornizë për të mbajtur objektivat në drejtimin e duhur.


Suksesi i një plani është i lidhur me informacionin mbi të cilin bazohet. Rezultatet e vlerësimit duhet të udhëheqin planin dhe t'i ndihmojnë partisë që të caktojë qëllimet.

### Shumica e planeve ju përgjigjen tre pyetjeve themelore:

- Ku duam të shkojmë?
- Si do të arrijmë atje?
- Kur do të arrijmë?

## Vendosja e qëllimeve të integritetit

Detyra e parë e planifikimit të reformës është artikulum i qëllimeve që do të kontribuojnë në ndryshimin e partisë. Megjithëse qëllimet mund të jenë rezultatet kryesore të gjëra që kërkohen të arrihen, ato gjithashtu duhet të jenë S.M.A.R.T. (shih Fletën e punës 1 për të identifikuar caqet S.M.A.R.T. të partisë )



Të qënit **specifik** për një qëllim do t'i ndihmojë partisë që të përqendrojë përpjekjet e saja dhe të komunikojë ndryshimin që dëshiron ta bëjë. Për shembull, nëse objektivi i përgjithshëm i partisë është të ngrisë integritetin e saj në verifikimin (vetingun) e kandidatëve, duhet konkretisht të artikulojë, qëllimin(et) e nevojshëm(e) për të arritur integritetin e përgjithshëm gjatë verifikimit (vetingut) të kandidatëve, duke përdorur përgjigjet e vlerësimit si një udhëzues. Për shembull, nëse nuk ka një organ të brendshëm përgjegjës për verifikimin (vetingun) e kandidatëve, qëllimi mund të jetë që partia të krijojë një komision që do të ngarkohet me verifikimin (vetingun) e kandidatëve. Sidoqoftë, krijimi i një komisioni, në vetvete, nuk është shumë specifik, dhe nuk është një tregues se verifikimi (vetingu) i kandidatëve po ndodh në parti. Partia duhet të artikulojë se kush do të përfshihet në përzgjedhjen dhe pjesëmarrjen në komision dhe t'u përgjigjet pyetjeve të tjera. Për shembull:

- Çfarë dëshiron partia që të arrijë komisioni?
- Si do ta zhvillojë komisioni punën e vet?
- Çfarë kritere do të përdorë komisioni për të verifikuar kandidatët (veting)?
- Cilët kandidatë do t'i verifikojë (veting) komisioni?
- Deri kur do të t'i verifikojë (veting) komisioni kandidatët për cilat zgjedhje?
- Kujt i raporton komisioni?

Sa më specifik të jetë një qëllimi, aq më i **matshëm** është. Si mund të masë partia suksesin e krijimit të një komisioni partiak që angazhohet në verifikimin (vetingun) e kandidatëve? Meqenëse do të ketë disa hapa për të aktivizuar komisionin, partia duhet të zhvillojë pikarritje të matshme për të përcjellë përparimin e reformës dhe për të vendosur standardet për sukses. Sapo të formojë partia një komision, ajo mund të përcjellë dhe të masë, për shembull, kush dhe sa anëtarë e përbëjnë komisionin. Gjithashtu mund të përcaktojë caqe për numrin e kritereve që përdor komisioni dhe numrin e kandidatëve të verifikuar nga komisioni.

Për të përcaktuar nëse qëllimi është i **arritshëm**, pyesni se cilat aftësi dhe informacione kërkohen për të arritur qëllimin. Për shembull, a kanë njerëzit që do të përfshihen në hapat e ndryshme të themelimit dhe pjesëmarrjes në komisionin për verifikim (veting) të kandidatëve, kohë për t'i kushtuar kësaj? Nëse jo, a ka të tjerë që mund të sillen për të kontribuar në këtë reformë? A ka partia informacione të mjaftueshme për kriteret e verifikimit (vetingut) dhe praktikatat e mira për të krijuar një proces dhe për të filluar verifikimin (vetingun) e kandidatëve? Nëse jo, ku mund të merr këtë informacion? Përfundimisht, partia do të duhet të përcaktojë nëse qëllimi është i arritshëm. A do të jetë reforma diçka që në të vërtetë mund të miratohet dhe adoptohet nga partia?

Derisa një qëllim mund të duket i nevojshëm dhe ka gjasa të rrisë integritetin e partisë, partia duhet të përcaktojë nëse kjo gjë është **relevante**. Partitë politike kanë prioritetet e panumërta të cilat garojnë me njëra-tjetrën dhe konsiderime strategjike që shpesh rrotullohen rreth cikleve zgjedhore. Për shembull, krijimi i një komisioni për veting të kandidatëve, do të marrë kohë dhe energji në llogari të aktiviteteve të tjera. Partia duhet të konsiderojë nëse qëllimi përputhet me strategjinë e përgjithshme të partisë dhe nëse kjo është koha e duhur për të zbatuar reformën.

Më në fund, qëllimet duhet të jenë të **kufizuara në kohë**. Një përkushtim ndaj një afati ndihmon që të gjithë të përqendrohen drejt përfundimit të qëllimit dhe parandalon që reforma të parakalohet nga ngjarje të tjera, të pa ndërlidhura.

## Identifikimi i aleatëve të integritetit

Pasi që partia ka artikuluar dhe priorizuar qëllimet e integritetit, ajo duhet të përcaktojë se si do t'i zbatojë ato qëllime. Kush janë aleatët dhe kundërshtarët natyrorë të reformave? Shqyrtoni hierarkinë organizative të partisë dhe identifikoni se kush do të përfitonte nga ndryshimi dhe kush mund të humbë ndikimin, fuqinë dhe brimet. Madje edhe reformat më të mira kanë kundërshtarë të brendshëm. Në mënyrë të pashmangshme, do të ketë kolegë, zyrtarë të zgjedhur dhe anëtarë me ndikim të madh të cilët do të punojnë për të ndaluar debatin ose zbatimin e ndryshimeve. **Para se të filloni të ndërtoni një bazë të përkrahësve, është me rëndësi që të përgjigjeni: Kush është i interesuar në ruajtjen e status quo-së, dhe kush përfiton nga ajo?**

Pasi që të përcaktoni se cilët individë dhe grupe kanë gjasa që të kundërshtojnë reformën, atëherë hapi i ardhshëm logjik është të identifikohet se ku do të gjejë mbështetje procesi i ndryshimit. **Mbështetësit brenda partisë** nuk janë domosdoshmërisht udhëheqësia; ndërsa anëtarë të ndryshëm mbështesin aspekte të ndryshme të nismave për reformën e integritetit. Për shembull, anëtarët e krahut të grave mund të duan që t'i japin prioritet shkallës së përfshirjes së tyre mbi sferat tjera të reformës.

Mund të ketë **aleatë jashtë partisë**, veçanërisht **organizatat e shoqërisë civile (OSHC)** që përqendrohen në çështjet e integritetit ose përfshirjen e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar për të pasur një kuptim real dhe qasje bashkëpunuese ndaj reformës partiake. Për shembull, nëse partia është e interesuar të kuptojë se cilat reforma janë të nevojshme për ta bërë atë më gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara (PAK), këshillimi me OShC-të që promovojnë të drejtat e PAK do të forcojnë reformat e propozuara dhe do të japin peshë në bindjen e njerëzve brenda partisë për ndryshimet e nevojshme. Për të përcaktuar se kush mund ta mbështesë nismën, është e dobishme që të identifikohen palët e interesuara dhe përkrahësit dhe të kuptohet se çfarë është ajo që i motivon ata. Është thelbësore të dihet se kush mund t'i rezistojë reformës dhe pse. Modeli i mëposhtëm paraqet një vegël të dobishme. (shih Fletën e punës 2 për të identifikuar aleatët partiakë për integritet)

**Tabela 2: Identifikimi i aleatëve të integritetit**

QËLLIMI I INTEGRITETIT TË PARTISË TONË ËSHTË: _____				
Shqyrtoni dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.				
KUSH DUHET TË NDIKOHET?				
<b>Palët e interesit</b>	Sa do të ndikohen ata nga ky veprim?	Çfarë ndryshimi do të duhet t'i përshtaten?	Si do të reagojnë fillimisht?	Çfarë u nevojitet për të mbështetur politikën?
<b>Përkrahësit</b>	A është mbështetja e tyre e fuqishme apo e dobët?	Pse e mbështesin qëllimin tim apo reformën?	Si mund ta shfrytëzoj maksimalisht mbështetjen e tyre?	Kush i ndikon ata dhe a mund të bashkëngjiten për të ndihmuar?
<b>Oponentët</b>	A do të jetë opozita e tyre e fuqishme apo e dobët?	Si do të duket kundërshtimi i tyre?	Si mund ta minimizoj kundërshtimin e tyre?	Kush i ndikon ata dhe a mund të bashkëngjiten për të ndihmuar?



Përveç kësaj, ekzistojnë aftësi të caktuara personale të nevojshme që duhet të zhvillohen dhe përsosen me kalimin e kohës.


**Ndikimi:** Zhvilloni dhe ndani një vizion të rezultatit të dëshiruar për reformën e integritetit. Përqendrohuni në motivimin e aleatëve për të punuar së bashku për ta bërë vizionin realitet, sesa duke përdorur forcën ose detyrimin. Ndikimi është një themel për besimin dhe besueshmërinë me kalimin e kohës.

**Avokimi:** Bëhuni avokues dhe mbështesni reformën e integritetit, duke analizuar cilat janë çështjet, pse nevojiten ndryshime dhe kush duhet të jetë shënjestra e përpjekjeve të mbrojtjes së integritetit.

**Dëgjimi efektiv:** Thithni informacione, tregoni interes dhe jepni informata kthyesë për folësin në mënyrë që ata të dinë se mesazhi është marrë. Dëgjimi është i rëndësishëm sepse tregon kujdes, krijon besim, tregon përkushtim dhe nxjerr në pah vlerat e ndjeshmërisë dhe respektit të ekipit të integritetit si udhëheqës.

**Të folurit në publik:** Jepni mesazhe të qarta dhe efektive. Siç u përmend, një kusht themelor për të fituar përkrahje për reformën e integritetit është ndërtimi i marrëdhënieve të bazuara në mirëbesim. Si i tillë, ekipi i integritetit duhet të demonstrojë dhe të komunikojë në mënyrë efektive pse reforma është e nevojshme dhe si përfiton partia nga kjo.

**Figura 3: Hartimi i fuqisë për reformën e integritetit**



## Hartimi i fuqisë

Kur paraqitet mundësia e duhur, reformatorët duhet të përgatiten për të vepruar. Pavarësisht se a bëhet paraprakisht ose si pjesë e nismës për reformë, **të kuptuarit e marrëdhënieve të fuqisë brenda partisë është thelbësore**. Disa njerëz do të mbështesin reformën, ndërsa të tjerët do ta kundërshtojnë atë. Disa njerëz, ose grupe njerëzish, do të preken drejtpërdrejt, ndërsa të tjerët jo. Disa individë janë me ndikim, të tjerët jo. Ndani kohë për të identifikuar palët e interesuara, përkrahësit dhe oponentët në mënyrë specifike për të kuptuar se si lidhen me reformën dhe me njëri-tjetrin. Një mënyrë e shkëlqyeshme për ta bërë këtë është hartimi i fuqisë. Modeli sipër mund të ndihmojë për të mësuar se ku qëndrojnë të gjithë dhe të ofrojë sugjerime se si t'i qaseni atyre gjatë zbatimit të planit (shih Fletën e punës 3 për të kryer ushtrimin e hartimit të fuqisë).

## Arritja e kompromisit në reformën e integritetit

Shpesh, ekipi i integritetit do të duhet të bëjë kompromise në disa aspekte të iniciativave për reforma për të fituar përkrahës të caktuar dhe për të gjeneruar fitore të shpejta për reformën. Ekipi i integritetit duhet të përcaktojë se ku, dhe mbi çfarë, është i gatshëm të bëjë kompromis në mënyrë që të jetë i gatshëm të negociojë me aleatët e mundshëm. Disa individë përpiqen të zbusin reformat ose të përpiqen të heqin ose ndryshojnë përbërës thelbësorë. **Identifikimi se kush kërkon të bëjë kompromis dhe kush është i interesuar për bashkëvepruar do të jetë një aktivitet i vazhdueshëm gjatë gjithë procesit të reformës**. Ndërtimi i një koalicioni të mbështetësve të brendshëm dhe të jashtëm për ndryshim nuk është e lehtë. Ekipi i integritetit duhet të jetë autentik dhe i aftë që të japë rezultate.

Vetë reforma e integritetit duhet të jetë joshëse dhe inovative, duke mbetur praktike. Sidoqoftë, kombinimi i një agjenti të ndryshimit të mençur dhe një reforme bindëse e bëjnë që më lehtë të ndërtohet një koalicion i përkrahësve të përkushtuar për të ndihmuar që reforma të realizohet sa më lehtë.

## Përcaktimi i momentit më të mirë për zbatimin e reformave të integritetit

Një element kryesor i suksesit për të arritur ndryshime kuptimplote është koha. Krizat dhe ngjarjet e papritura mund t'i prishin planet më të mira dhe të shpërqendrojnë reformatorët më të përkushtuar. Disa momente janë më të mira se të tjerat për të tërhequr vëmendjen e aleatëve dhe vendimmarrësve. Për shembull, gjatë një fushatë zgjedhore nuk është koha më e mirë për të propozuar ndryshime të mëdha organizative brenda partisë për të cilat nevojiten muaj për tu realizuar. Megjithatë, është kohë e përshtatshme për të propozuar ndryshime për çështjet e lidhura me integritetin siç është kostoja e politikës për kandidatët ose për t'u komunikuar të tjerëve kundërshtimin e partisë për blerjen e votave. Të kuptuarit se kur zyrtarët e partisë dhe aktivistët janë më të hapur për të konsideruar ndryshime është jetike për strategjinë e një reformatori, në mënyrë që ndërhyrjet e integritetit të kenë ndikimin maksimal.






Njohja e rasteve të papritura për ndryshim gjithashtu mund të ndikojë në kohën e zbatimit të reformës. Mundësitë për reformë ndonjëherë mund të paraqiten në momente të paparashikuara. Shpesh herë një krizë në një parti ose vend jep mundësinë për ndryshim. Në qoftë se agjentët e ndryshimit nuk janë të përgatitur, mund të jetë sfiduese që të përfitohet nga një dritare e paçmueshme për transformim.

## Komunikimi i progresit drejt integritetit te publiku

Nëse partia me sukses ka zbatuar reformat e integritetit, është e rëndësishme që t'ia komunikojë këtë sukses anëtarëve të partisë dhe qytetarëve. Shumica e qytetarëve jashtë partisë nuk e kuptojnë gjithmonë rëndësinë ose rolin e praktikave të brendshme të partisë, aktet nënligjore ose statutet. Nëse reforma e partisë ka rezultuar me ndryshimin e dokumenteve të partisë, partia duhet të interpretojë këto ndryshime në një mënyrë që opinioni i gjerë t'i kuptojë. Flisni për ndryshimin e sjelljes që do të rezultojë për shkak të reformës dhe identifikoni një sërë njerëzish të ndryshëm për t'a komunikuar suksesin e partisë.

Meqenëse anëtarët e partisë janë përkrahës të shkëlqyeshëm të ndryshimit pozitiv të partisë, angazhoni ata në mënyrë kuptimplote në përpjekjet për të komunikuar mesazhin e partisë. Kërkoni aleatë të jashtëm që kanë qenë të angazhuar në përpjekjet e reformave ose të cilët do të jenë të interesuar për gjestin e partisë për të përmirësuar integritetin e saj. Organizatat e kundër korrupsionit dhe aktivistët që promovojnë përfshirjen e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar do të jenë mbështetës të reformave.

### Kur hartoni një plan komunikimi, merrni parasysh gjërat në vijim:

	Zhvilloni dhe shpërndani mesazhe në lidhje me reformat që mund të miratohen nga anëtarët në të gjithë vendin dhe që mund të përdoren gjatë komunikimit publik.
	Zhvilloni dhe shpërndani pika të bisedës dhe mesazhe të shkurtra që mbështetësit mund t'i postojnë në platformat e tyre të mediave sociale (me foto dhe hashtags).
	Hartoni një opinion nga lideri për t'ua shpërndarë gazetarëve për të zgjeruar komunikimin e partisë përtej mbështetësve dhe anëtarëve të saj.
	Regjistroni një video të kryesisë partiake duke diskutuar reformat që mund të kuptohet lehtë, të distribuohet dhe të integrohet në materialet promovuese të partisë.
	Organizoni një takim të tryezës së rrumbullakët me OShC-të dhe mediat relevante për të marrë mendime kthyesë (dhe mbështetje) për reformat.

Mbani mend, komunikimi për ndryshimet dhe reformat në parti nuk ka të bëjë me partinë, por ka të bëjë me votuesit dhe me atë se pse reformat e integritetit janë të mira për publikun. Hartoni mesazhet dhe strategjitë e komunikimit të partisë për të treguar se si qytetarët përfitojnë nga integriteti i përmirësuar i partive politike.

**Tabela 3: Këshilla për zbatimin e gjetjeve të vlerësimit të integritetit**

<b>Këshilla për zbatimin e gjetjeve të vlerësimit të integritetit</b>	
	Hartoni një vizion të qartë dhe bëni një përshkrim të fushëveprimit të ndryshimit. Çfarë do të bëjë? Kujt do t'i ndikojë? Si do të përfitojë partia nga kjo reformë?
	Krijoni një ekip aleatësh. Komunikoni me palët e interesuara dhe përkrahësit të cilët mund të ndikohen nga reforma—veçanërisht ata që përfaqësojnë bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar.
	Krijoni një listë gjithëpërfshirëse të detyrave të nevojshme për të përfunduar reformën. Bëhuni specifik! Secila detyrë duhet të ketë një objektivi me një afat kohor për ta përfunduar atë. Caktoni detyra individëve të caktuar. Bëhuni realist për atë se sa mund të bëjë një person. Më shumë individë mund të kontribuojnë në të njëjtën punë, por duhet të ketë një person përgjegjës për të ndjekur progresin dhe për të siguruar përfundimin e tij.
	Identifikoni se cilat veprime kanë nevojë për para. Identifikoni burimet e të ardhurave për detyrat që kanë nevojë për para dhe bëni plane emergjente nëse burimet nuk janë të disponueshme.
	Ndani kohë për të bërë hulumtimin e nevojshëm në sferat e reformës në mënyrë që partia të jetë e pajisur për të zbatuar reformën e integritetit.
	Studioni dhe njihuni me rregullat brenda dhe jashtë—kjo nënkupton rregulloret e partisë, aktet nënligjore ose kushtetutën. Ndonjëherë avantazhi më i madh vjen me njohjen e rregullave më mirë se kushdo tjetër.
	Identifikoni vijat e kuqe—kufijtë dhe limitet që nuk duhet të kalohen—dhe përcaktoni se si të menaxhohet qasja ndaj tyre.
	Identifikoni stimujt që motivojnë udhëheqësinë e partisë dhe komisionet e nevojshme për të ndryshuar. Vlerësoni mundësitë për të shfrytëzuar këto stimuj.
	Hulumtoni proceset formale dhe joformale të cilat partia i përdor për të miratuar dhe ndryshuar statutet dhe aktet nënligjore. Hartoni se ku janë mundësitë për të ndikuar në procesin(et) e vendimmarrjes dhe palët kryesore të interesit.
	Artikuloni rreziqet ndaj planit dhe zhvilloni strategji lehtësuese nëse nisma e reformave ngec.
	Përpiloni pika bisede për atë se çfarë çështjesh do të zgjidhë reforma, përse zgjidhja do të jetë efektive dhe se si mund të zbatohet me sukses. Flisni se si ndryshimi do të ndikojë pozitivisht në parti dhe do të rrisë integritetin. Përgatitni shembuj se si nisma të ngjashme kanë ndihmuar partitë tjera.

**Tabela 4: Shembull i fletës së punës së Planit të zbatimit dhe vlerësimit të integritetit**

Emri i partisë: Partia Punëtore e Paldovisë							
Qëllimi i reformës së integritetit: Të gjitha organet vendimarrëse të partisë të përbëhen nga 50% gra në dy vitet e ardhme.							
Aleatët e integritetit: Sekretari i përgjithshëm, Kryesueset e krahut të grave, krahut të rinisë dhe krahut politik							
Aktiviteti	Buxheti	Personi përgjegjës	Tregues i progresit	Afati kohor	Shpeshtësia e evaluimit	Status	A ka rreziqe lidhur me këtë aktivitet dhe çfarë mund të bëhet për të zbutur ato?
<b>Aktiviteti 1:</b> Konsulenca me Sekretarin e përgjithshëm, Kryesuesit e krahut të rinjëve, të grave dhe krahut politik	100 dollarë për pije freskuese dhe ushqime të lehta	Anëtar i ekipit të integritetit "A", nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të ekipit të integritetit	Angazhime dhe mbështetje kuptimplote nga Kryesuesit	Muajt 1-3	Javore	Takimi me krahun e të rinjëve dhe të grave është i kompletuar.  Tani planifikohen takime me krahun politik dhe sekretarin e përgjithshëm	<b>Rreziqet:</b> Caktimi i takimeve ndeshet me kohën e zënë të kryesuesve të ndryshme.  Për të lehtësuar situatën, planifikoni takimet paraprakisht dhe konfirmoni oraret para se të ndodhin konsultimet.
<b>Aktiviteti 2:</b> Rritja e anëtarësimit të grave me 50%	5,000 dollarë për shtypjen e fletushkave partiake, transporti dhe përcjellje	Anëtarët e Ekipit të integritetit "B" dhe "C", me mbështetje nga krahu i grave, krahu rinor dhe krahu politik, nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Ekipit të integritetit	Numri i grave të rekrutuara si anëtare në bazë mujore	Muajt 3-24	Dyjavore	Planet vijuese derë-më-derë me Kryesuesen e krahut të grave, kryesuesin e krahut të rinisë, kryesuesin e krahut të rinisë dhe kryesuesin e krahut politik.  [Emri i partisë] Planifikimi i konferencës politike të grave akoma nuk ka filluar.	<b>Rreziqet:</b> Gratë mund të mos dëshirojnë të anëtarësohen në parti.  <b>Lehtësim:</b> Zhvilloni një plan të fuqishëm të komunikimit dhe synoni gratë në bastionet partiake dhe në mjediset konkurruese.

Aktiviteti	Buxheti	Personi përgjegjës	Tregues i progresit	Afati kohor	Shpeshtësia e evaluimit	Status	A ka rreziqe lidhur me këtë aktivitet dhe çfarë mund të bëhet për të zbutur ato?
<b>Aktiviteti 3:</b> Zbatoni reformën për të rritur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen e partive	3,000 dollarë për shtypje plotësuese të materialeve për takime, një hapësirë më e madhe takimesh dhe pije freskuese plotësuese dhe ushqime të lehta.  100 dollarë pije freskuese dhe ushqime të lehta për konsultime, në qoftë se është e nevojshme.	Anëtarët e Ekipit të integritetit "A" dhe "D", me mbështetje nga krahu i grave dhe krahu rinor, nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të Ekipit të integritetit	Numri i emërimeve të reja të grave në pozita vendimmarrëse	Muajt 10-24	Dyjavore	Avokimi i brendshëm në vijim, duke filluar me takimet e kryesuesve të ndryshëm të partive dhe zyrtarëve dhe zyrtarëve për vlerën e angazhimit së grave në pozitat vendimmarrëse.  Kërkimi i hapësirave të mundshme për takimet që janë në vijim e sipër.	<b>Rreziqet:</b> Anëtarët në pozitat vendimmarrëse nuk pajtohen që gratë duhet të luajnë këtë rol brenda partisë.  <b>Lehtësim:</b> Identifikimi i stimujve për pjesëmarrje më të madhe të grave dhe komunikimi me anëtarët skeptikë.

**Shihni Fletën e punës 5 për të filluar hartimin e planit të zbatimit të integritetit të partisë.**

# UDHËZIM SE SI TË MONITOROHET DHE VLERËSOHET PËRPARIMI DREJT REFORMËS SË INTEGRITETIT

### **Pse është me rëndësi monitorimi dhe vlerësimi i reformës së integritetit?**

Monitorimi dhe vlerësimi ofrojnë një sistem për mbledhjen e vazhdueshme të informacionit për të zbuluar nëse përpjekjet për reformën e partisë janë në rrugën e duhur dhe nëse rezultatet e pritura janë duke u realizuar. Vlerësimet që bazohen në prova, të mbledhura me kalimin e kohës përmes monitorimit, ofrojnë një pasqyrë në procesin e reformës së integritetit të partisë dhe identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta të procesit. Informacioni që rezultojnë nga vlerësimi do të shërbejë si një bazë për informata kthyes ndaj udhëheqësisë, anëtarësisë dhe aktivistëve dhe audiencave të tjera të ndryshme, duke përfshirë vendimmarrësit, donatorët politikë, stafin dhe elektoratet e tjera përkatëse ose palët e interesuara. Ndihejmon për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe formulimin e politikave me informacione të bazuara në prova.

Siç u përmend në pjesën e mëparshme, zbatimi i reformave të integritetit kërkon zhvillimin e një plani. Një pjesë e procesit të planifikimit duhet të përfshijë një metodologji për të monitoruar progresin dhe për të vlerësuar efektivitetin e përpjekjeve për reformën e partisë. Monitorimi dhe vlerësimi nuk janë mendime dytësore ose diçka që partia harton ose zbaton pasi të kenë filluar reformat e integritetit. Duhet të jetë një element themelor i planifikimit dhe i procesit të zbatimit të reformës së integritetit të partisë.

- **Monitorimi** është një proces i vazhdueshëm që mbledh informacione për të përcjellur përparimin e partisë drejt reformave të integritetit.
- **Vlerësimi** identifikon ndryshimet që rezultojnë nga reformat e integritetit të partisë. Përcakton nëse reforma e partisë ka pasur sukses dhe ka realizuar atë që pritej.

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit dhe i rezultateve kërkon kohë dhe burime njerëzore për të mbledhur dhe për të analizuar informacionet. Ekzistojnë disa përfitime nga monitorimi dhe vlerësimi i reformave të integritetit:

- **Llogaridhënia**—e mbanë udhëheqësinë përgjegjëse për angazhimin e saj ndaj reformës së integritetit dhe u jep vetëbesim anëtarëve se partia po lëvizë drejt rritjes së integritetit.
- **Mbikëqyr mbarëvajtjen e zbatimit**—siguron një hartë të qartë të qarisë për ekipin e ngarkuar me zbatimin e reformave të integritetit, duke përfshirë këtu edhe objektivat e asaj se çfarë duhet të bëhet.
- **Mësim dhe përmirësim**—jep mundësi për reflektim dhe mundësi për t'iu përshtatur rrethanave. Gjithashtu i kontribuon efikasitetit të punës, veçanërisht nëse të gjithë i kuptojnë qëllimet e reformës.
- **Provat për avokim**—të dhënat e mbledhura përmes monitorimit dhe vlerësimit mundësojnë argumente të bazuara në prova për reformën dhe përpjekjet e vazhdueshme për integritet.
- **Marrëdhëniet me publikun**—informacionet dhe tregimet e mbledhura përmes monitorimit dhe vlerësimit mundësojnë që partia të përgatisë informacione për t'u përdorur në promovimin e partisë politike.
- **Alokimi i resurseve**—i mundëson partisë të identifikojë burimet e nevojshme për të zbatuar reformën.
- **Matja e ndikimit**—lejon mbledhjen e të dhënave që demonstrojnë ndikimin e reformës së partisë.

Ekzistojnë disa mënyra të ndryshme për të monitoruar dhe vlerësuar përpjekjet e partisë për reformë, por të gjitha i përgjigjen katër pyetjeve universale:

- A po zbaton partia imë reformat e integritetit?
- A po ndryshojnë gjërat si rezultat i reformave të integritetit?
- A janë të prioritizuara reformat e integritetit ashtu si duhet?
- Çfarë më tregojnë të dhënat?

## Teknikat e monitorimit dhe vlerësimit

Ekzistojnë disa teknika monitorimi dhe vlerësimi të cilat përdoren për të vlerësuar progresin dhe rezultatet e reformave të integritetit. Për monitorim, partia duhet të identifikojë një ose dy persona që do të mbledhin dhe analizojnë progresin drejt reformave të integritetit. Zgjedhja e teknikës më të mirë për vlerësim varet nga faza e procesit të reformës së integritetit në të cilën gjindet partia. Secila mund të ndihmojë partinë që të sjellë vendime më të mira duke i dhënë asaj informacione. Këtu shfaqim disa teknika vlerësimi që partia mund t'i zbatojë:

- **Vlerësimet formuese janë vlerësime për të mësuar** Ato shpesh janë joformale dhe bëhen përbrenda. Qëllimi i tyre është t'i sigurojnë partisë një vlerësim se si po zbatohen aktualisht reformat dhe i mundësojnë partisë të përshtasë procesin e zbatimit në përputhje me rrethanat.
- **Vlerësimet e procesit përqendrohen në mënyrën se si është zbatuar reforma dhe si funksionon ajo.** Ngjashëm me vlerësimet formuese, vlerësimet e procesit gjithashtu ndodhin derisa partia është duke kryer reformat e integritetit. Qëllimi është për të parë nëse reforma po i përmbush qëllimet e saja të planifikuara. Kjo përfshin edhe të shihet se si zbatohet reforma dhe çfarë ka arritur.
- **Vlerësimet e rezultateve bëhen pas përfundimit të zbatimit të reformës së integritetit.** Vlerësimet e rezultateve masin ndikimin afatshkurtër të reformës së integritetit. Kjo mund të ndihmojë në vlerësimin e ndikimit fillestar që ka reforma dhe si është pranuar. Partia gjithashtu duhet të masë edhe ndikimin afatgjatë të reformës dhe efektivitetin e përgjithshëm të realizimit të qëllimeve të saja. Për ta bërë këtë, partia duhet të mbajë evidencë të ndryshimeve që ndodhin



gjatë periudhave më të gjata kohore. Vlerësimet afatgjata japin një perspektivë më të gjerë dhe më të plotë të rezultateve nga reforma e integritetit.

## Si të monitorohet dhe të vlerësohet progresi

Si dhe çfarë duhet monitoruar dhe vlerësuar do të varet nga reforma e integritetit të cilën po e zbaton partia. Kur planifikohet të monitorohen dhe vlerësohen reformat e integritetit, përfshini edhe ekipin themelor të vlerësimit. Ekipi që ka analizuar rezultatet e vlerësimit dhe ka hartuar qëllimet e reformës është në pozitën më të mirë për të ditur se çfarë mund të monitorohet dhe cilat do të jenë rezultatet e pritura. Nëse partia ka zhvilluar qëllimet S.M.A.R.T për planin e saj të zbatimit, partia do të jetë në një pozitë të shkëlqyeshme për të vlerësuar reformat e integritetit.

### Kur monitorohen dhe vlerësohen intervenimet e partisë, ajo do të duhet të përcaktojë:

- Informacioni fillestar, në bazë të të cilit partia do të monitorojë dhe do të vlerësojë progresin.
- Cilët tregues i përdor partia në zbatimin e saj si njësi matëse.
- Burimi(et) i treguesve të partisë.
- Si partia do të mbledhë dhe do të analizojë të dhënat .
- Kur, dhe sa shpesh, partia do t'i mbledhë dhe analizojë të dhënat.
- Kush do të mbledhë dhe do të analizojë të dhënat .

Kur monitorohet ose vlerësohet zbatimi dhe arritjet e programit, partia ka nevojë ka nevojë për informacion **fillestar**, në bazë të cilit do të krahasojë dhe vlerësojë. Nëse partia vet e ka kryer vlerësimin e integritetit, ajo i posedon të dhënat e saja fillestare. Për shembull, nëse partia ka vendosur se dëshiron të formojë një komision për ta angazhuar në vetingun e kandidatëve sepse aktualisht nuk ka komision, atëherë informacioni fillestar i partisë për të gjithë treguesit është zero. Treguesit gjithashtu duhet të jenë të saktë dhe të përcaktuar në terma të qartë.

**Treguesit** janë matje të cilat sigurojnë provën për ndryshime. Ekzistojnë disa karakteristika të treguesve të mirë. Në minimum, treguesit duhet të jenë të vlefshëm në atë që ata matin, në fakt, atë që ata synojnë të matin. Ata gjithashtu duhet të jenë të besueshëm në mënyrë që të matin vazhdimisht, në të njëjtën mënyrë, nga vëzhgues të ndryshëm. Treguesit gjithashtu duhet të jenë të saktë dhe të definuar qartë.

Duke përdorur këto karakteristika si udhëzues, partia mund të zgjedh tregues për të përcaktuar se a e ka arritur qëllimin e saj. Për shembull, një rregullore e re e partisë për krijimin e një komisioni të vetingut të kandidatëve nuk është një tregues i vlefshëm se partia në të vërtetë ka një komision i cili funksionon. Një tregues më i besueshëm, i vlefshëm dhe i saktë do të ishte numri i zyrtarëve të partisë që marrin pjesë në komision. Treguesit e tjerë mund të përfshijnë kriteret specifike që komisioni i përdor për të bërë vetingun e kandidatëve, numrin e kandidatëve të cilët kanë kaluar vetingun nga komisioni dhe numrin e raporteve që komisioni përgatit lidhur me aktivitetet e tij.

Kur monitoron dhe vlerëson reformën e integritetit të partisë, partia gjithashtu duhet të theksojë **burimin(et) e treguesve të tij**. Për shembull, një burim i rëndësishëm për të mbledhur treguesit për një komision të vetingut të kandidatëve janë vetë anëtarët e atij komisioni. Ata do të jenë në gjendje t'i ofrojnë partisë informacione mbi proceset e tyre. Partia gjithashtu mund të konsultojë edhe procesverbalet nga mbledhjet e komisioneve, si dhe vetë kandidatët e mundshëm të cilët janë takuar me komisionin.

Duke ditur se **si partia do t'i mbledhë dhe do të analizojë informacionet** do ti ndihmonte ekipit që të kuptojë detyrat ose burimet e nevojshme për të kryer monitorimin dhe vlerësimin. Për shembull, a do të bëjë partia intervista sy-më-sy me anëtarët e komisionit për veting të kandidatëve dhe kandidatët? A do ta intervistojë partia kryesinë e partisë për informata kthyesë mbi punën e komisionit? A do t'i kërkojë partia anëtarëve të komisionit të plotësojnë një pyetësor? A do të mbajë partia një diskutim në fokus grup me komisionin ose kandidatët potencial? Apo, a do t'i shqyrtojë partia dokumentet e partisë dhe procesverbalet nga mbledhjet? Pasi që partia t'i mbledh të dhënat, mendoni për mënyrat e ndryshme se si mund t'i analizojë ato. Nëse janë të dhëna cilësore, a do të bëjë partia një trend ose analizë të përmbajtjes? A do t'i kodojë partia ato duke përdorur një softuer specifik? Nëse janë të dhëna sasiore (kuantitative), a do të bëjë partia analiza statistikore? Çfarë softueri do të përdorë partia? A do të punësojë partia një analist të të dhënave për të ndihmuar me analizën?

Të dihet se **kur ose sa shpesh partia do të mbledhë dhe analizojë të dhënat** gjithashtu ndihmon ekipin të planifikojë kohën për detyrat. Meqenëse mund të ketë disa hapa për formimin dhe funksionimin e një komisioni, partia do të ketë afate të ndryshme kohore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave për tregues të ndryshëm.

Më në fund, është esenciale që të theksohet se **kush do të mbledhë dhe analizojë të dhënat**. Duke mos caktuar persona specifikë për detyra të caktuara, plani i partisë për të vlerësuar reformën e saj të integritetit rrezikon të dështojë si viktimë e paqartësisë (shih Fletën e punës 4 për të filluar planifikimin për vlerësim dhe mbledhje të dhënave).

**Tabela 5: Shembull i fletës së punës për mbledhjen e të dhënave të vlerësimit**

<b>Qëllimi i integritetit të partisë tonë është:</b> Organet vendimmarrëse të Partisë Punëtore të Paldovisë përbëhen nga 50% gra në dy vitet e ardhme..				
<b>Numri fillestar / aktual:</b> 10 gra në të gjitha organet vendimmarrëse			<b>Rritja e synuar:</b> 40 gra, që përbëjnë 50% të të gjitha organeve vendimmarrëse	
<b>Tregues</b>	<b>Burim i të dhënave</b>	<b>Si do të mbledhim dhe të analizojmë të dhënat</b>	<b>Kur do të mbledhim dhe të analizojmë të dhënat</b>	<b>Kush do të mbledhë dhe do të analizojë të dhënat</b>
Numri ose përqindja e grave në organet vendimmarrëse	Dokumentet e partisë, duke përfshirë procesverbalet e mbledhjeve dhe memorandumet e vendimeve	Takime të shkurtra me gratë anëtare nga çdo organ	Mujore	Anëtari i ekipit të integritetit "A", dhe Udhëheqësi i ekipit të integritetit
Numri ose përqindja e vendimeve të marra nga gratë	Dokumentet e partisë, duke përfshirë procesverbalet e mbledhjeve dhe memorandumet e vendimeve	Takime me anëtarët e çdo organi	Mujore	Anëtari i ekipit të integritetit "D", dhe Udhëheqësi i ekipit të integritetit
Numri ose përqindja e reformave partiake të zbatuara si rezultat i vendimeve të marra nga gratë	Dokumentet e partisë dhe vëzhgime të proceseve, strukturave dhe sjelljeve të partisë	Takime me liderët e lartë të partisë për informata kthyesë mbi reformat	Tremujori	Drejtuesi i ekipit të integritetit

## Interpretimi i vlerësimit në veprim

Vlerësimi i reformës së integritetit nuk është një qëllim në vetvete. Meqenëse vlerësimi është një proces sistematik i informatave kthyesë, është me rëndësi që partia t'i kthejë rezultatet e vlerësimit të partisë në veprim. Rrjedha e veprimit të partisë, do të varet, domosdoshmërisht, nga rezultati i vlerësimit të partisë.

**Nëse vlerësimi i partisë zbulon se partia ka zbatuar me sukses reformën e integritetit:** Urime! Pa dallim se a ka qenë qëllimi i partisë i vogël apo i madh, reformimi i strukturave të partisë dhe sjellja për të përfaqëuar integritetin është arsye për festim. Gjithashtu është një mundësi e shkëlqyeshme për të shfrytëzuar suksesin e partisë për të vazhduar rrugën e reformës për të zgjidhur boshllëqet tjera në integritetin e partisë dhe për të propozuar reforma të reja për përmirësime të mëtejshme.

Më e rëndësishmja është që një reformë e suksesshme e integritetit paraqet një mjet të jashtëzakonshëm të komunikimit dhe një mundësi për të angazhuar qytetarët. Komunikimi i nismave reformuese jashtë partisë ju tregon votuesve se partia ka priorizuar integritetin dhe do të tërheqë aktivistë dhe anëtarë të rinj me energji për të kontribuar në rritjen dhe suksesin e partisë.

**Nëse vlerësimi i partisë zbulon se partia ka zbatuar vetëm pjesërisht reformën e integritetit:** Jo të gjitha ndryshimet janë lineare ose ndodhin në një mënyrë siç dëshirojmë ose mund të parashikojmë. Nëse reforma e integritetit të partisë ka ngecur ose nuk është zbatuar në tërësi, duhet të kuptohet pse është kështu dhe se si partia duhet ta përmirësojë atë.

### Rishikoni planin e partisë për të identifikuar se çfarë mund të ketë shkuar gabimisht. Pyetni:

- A ishin qëllimet e partisë realiste?
- A nuk ishin aktivitetet relevante me qëllimin?
- A e penguan procesin ngjarje të papritura (të brendshme dhe të jashtme)?
- A ishte kundërshtimi ndaj reformës së partisë më i fuqishëm se sa pritej?

Rishikoni rreziqet dhe strategjitë e lehtësimit të cilat partia ka zhvilluar në planin e saj. Angazhoni udhëheqësinë e partisë dhe anëtarët e lartë të partisë në biseda të hapura dhe të sinqerta për sfidat në zbatimin e reformave partiake në tërësi. Pasi që partia të kuptojë se çfarë nuk ka shkuar si duhet, ajo mund të vendosë se si të rregullojë strategjinë e vet dhe të vazhdojë me zbatimin. Takohuni me aleatët e partisë brenda partisë dhe angazhoni anëtarët dhe aktivistët që ndajnë mendimet e njëjta për reformat kur planifikoni rrugën para.

Partia mund të vendosë se një gjysmë reforme është më e mirë se asnjë reformë. A mund që partia të punojë dhe të ndërtojë më tutje mbi arritjet deritanishme? Nëse partia është në gjendje që të demonstrojë efektivitetin dhe vlerën e një reforme të pjesshme, më tutje ajo mund të sigurojë më shumë mbështetje për një reformë gjithëpërfshirëse të integritetit. Më tutje, a i nevojitet partisë më shumë kohë për të realizuar qëllimet e saj? Nëse partisë i duhet më shumë kohë ose konstaton se nuk ka gjasa që reforma të vazhdojë përtej nivelit ku është tani, ndoshta është koha që të kthehemi në reforma më pak kontroverse të integritetit.

Ajo që është më e rëndësishmja është të mos hiqni dorë! Nëse partia tashmë është angazhuar në një vlerësim të integritetit të saj, atëherë ekziston një lloj gatishmërie tek disa për të përmirësuar partinë.

## FLETA E PUNËS 1



### PËRCAKTIMI I QËLLIMIT TË INTEGRITETIT TË PARTISË

#### Shumica e planeve u përgjigjen tre pyetjeve themelore:

- Ku duam të shkojmë?
- Si do të arrijmë atje?
- Kur do të arrijmë?

#### Vendosja e synimeve të integritetit

Detyra e parë e planifikimit të reformës është artikulli i qëllimeve që do të kontribuojnë në ndryshimin e partisë. Megjithëse qëllimet mund të jenë rezultate kryesore të gjera që partia ka për qëllim t'i arrijë, ato duhet të jenë gjithashtu S.M.A.R.T.: specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe kufizuara në Kohë.

### QËLLIMI I INTEGRITETIT TË PARTISË

## FLETA E PUNËS 2



### IDENTIFIKIMI I ALEATËVE TË INTEGRITETIT

Para se të filloni të ndërtoni një bazë mbështetjeje, është e rëndësishme të përgjigjeni: Kush është i angazhuar në ruajtjen e status quo-së dhe kush përfiton prej saj?

**QËLLIMI JONË I INTEGRITETIT PARTIAK ËSHTË :** \_\_\_\_\_

Merrni parasysh dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

#### KË DUHET TË NDIKONI?

Palët e interesit	Sa do të ndikohen nga ky veprim?	Me çfarë ndryshimi do të duhet të përshtaten?	Si do të reagojnë ata fillimisht?	Çfarë u nevojitet atyre për të mbështetur politikën?
Mbështetësit	A është mbështetja e tyre e fortë apo e dobët?	Pse e mbështesin qëllimin apo reformën time?	Si mund ta maksimizoj mbështetjen e tyre?	Kush ndikon tek ata dhe a mund të regjistrohen për të ndihmuar?
Kundërshtarët	A do të jetë kundërshtimi i tyre i fortë apo i dobët?	Si do të duket kundërshtimi i tyre?	Si mund ta minimizoj kundërshtimin e tyre?	Kush ndikon tek ata dhe a mund të regjistrohen për të ndihmuar?

## FLETA E PUNËS 3



### HARTËZIMI I ENERGJISË PËR REFORMËN E INTEGRITETIT

Disa njerëz do të mbështesin reformën dhe të tjerët do ta kundërshtojnë atë. Disa njerëz, ose grupe njerëzish, do të preken drejtpërdrejt, të tjerët jo. Disa individë janë me ndikim, të tjerët jo. Merrni kohë për të identifikuar palët e interesit, mbështetësit dhe kundërshtarët posaçërisht për të kuptuar se si ato lidhen me reformën dhe me njëri-tjetrin.

		→ DREJTIMI I NDIKIMIT →	
		Pozitive	Negative
↑ IFUQIA E NDIKIMIT ↑	FORTË		
	DOBËT		



**VLERËSIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE**

Një pjesë e procesit të planifikimit për reformën e integritetit duhet të përfshijë një metodologji për të monitoruar progresin dhe për të vlerësuar efektivitetin e përpjekjeve të partisë për reformën. Monitorimi dhe vlerësimi nuk janë mendime të mëvonshme ose diçka që partia harton ose zbaton pasi të fillojnë reformat e integritetit. Ai duhet të jetë një element themelor i procesit të planifikimit dhe zbatimit të reformës së integritetit të partisë.

**Monitorimi** është një proces i vazhdueshëm që mbledh informacione për të ndjekur progresin e partisë drejt reformave të integritetit.

**Vlerësimi** bën vlerësimin e ndryshimeve që rezultojnë nga reformat e integritetit të partisë. Ai përcakton nëse reforma e partisë ka pasur sukses dhe ka siguruar atë që pritej.

QËLLIMI I PARTISË ËSHTË:				
Pika bazë/praktika aktuale:			Synimi:	
Treguesi	Burimi i të dhënave	Si do të mbledhim dhe analizojmë të dhënat	Kur do të mbledhim dhe analizojmë të dhënat	Kush do të mbledhë dhe analizojë të dhënat



## FLETA E PUNËS 5

### PLANI I ZBATIMIT DHE VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT

Reformimi i një partie dhe zbatimi i ndryshimit fillon me hapa të vegjël. Ai gjithashtu fillon duke pasur një vizion për atë që partia dëshiron të ndryshojë, duke e ndarë atë vizion në pjesë të menaxhueshme dhe duke zhvilluar një plan për të zbatuar atë ndryshim.

<b>Emri i partisë:</b>								
<b>Qëllimi i reformës së integritetit:</b>								
<b>Aleatët e integritetit:</b>								
<b>Aktiviteti</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Personi përgjegjës</b>	<b>Treguesi i progresit</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Frekuenca e vlerësimit</b>	<b>Statusi i reformës</b>	<b>A ka rreziqe për këtë aktivitet dhe çfarë mund të bëhet për t'i zbutur ato?</b>	



# UDHËZIME PËR SHOQËRINË CIVILE DHE MEDIAT PËR TË NDIHMUAR PARTITË TË FITOJNË ME INTEGRITET

Partitë politike duhet të luajnë rol kyç në qeverisjen demokratike duke përfaqësuar qytetarët dhe duke përmbledhur shqetësimet e tyre në politika, ndërsa me anë të vetingut, të përzgjedhin dhe ndikojnë liderët politikë. **Sidoqoftë, korrupsioni, kapja e shtetit dhe organizatat e errëta partiake minojnë besimin e publikut në partitë në të gjithë botën, duke nxitur paqëndrueshmërinë politike.** Qytetarët gjithnjë e më shumë i perceptojnë partitë si të drejtuar nga elita dhe jo përfaqësues të qytetarisë më të gjerë; jo të gatshëm për të përfshirë dhe fuqizuar gratë dhe bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar; të papërkushtuar për transparencë dhe përgjegjshmëri; dhe përgjithësisht jo të besueshëm.

Një zgjidhje, e dëshmuar të bëjë ndryshim në ndryshimin e perceptimeve, është **kur partitë zgjedhin të dizajnojnë sistemet, qëllimin dhe etikën e tyre rreth parimit të integritetit.** Në mënyrë të konsiderueshme, kjo është edhe rruga që do të çojë në ndryshimet më domethënëse në mënyrën se si partitë politike vlerësohen nga votuesit.

Deri sa përgjegjësia për të rritur integritetin politik qëndron në mënyrë të fuqishme me partitë politike, shoqëria civile—organizatat, mediat dhe aktivistët—kanë një rol në luftimin e korrupsionit dhe promovimin e përfshirjes më të madhe në proceset politike. Shoqëria civile duhet t'i mbajë përgjegjësi hartuesit e politikave dhe të informojë qytetarët për veprimet dhe opsionet. Demokracitë përparojnë me angazhimin dinamik qytetar në zhvillimin e politikave dhe veprimeve politike. Indeksi i perceptimit të korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare (TI) 2019, zbuloi se “sistemet politike të cilat rrisin integritetin e procesit të rekrutimit politik dhe atë të vendimmarrjes janë më pak të ndjeshëm ndaj korrupsionit politik.” TI vuri në dukje se ekziston një lidhje midis konsultimeve të gjera në vendimmarrjen politike dhe niveleve më të ulëta të korrupsionit.<sup>27</sup> Jo çdo organizatë e shoqërisë civile e ka të njëjtin nivel të interesit në partitë politike dhe ndikimin e tyre brenda partive. Disa organizata të shoqërisë civile luajnë rolin e mbikëqyrësit duke u përfshirë në monitorimin e procesit politik si një mënyrë për t'i mbajtur përgjegjëse partitë politike. Organizatat e tjera në mënyrë aktive përpiqen të ndikojnë partitë

politike duke avokuar për reforma ose politika specifike. Në shumicën e vendeve, mediat nuk janë gjithmonë plotësisht objektive. Madje edhe mediat më profesionale dhe më të respektuara kanë disa paragjykime ndaj partive të caktuara.

### **Ekzistojnë dy sfera në të cilat shoqëria civile është e pozicionuar në mënyrë unike për të avancuar dhe forcuar integritetin e partive politike: avokimi dhe monitorimi.**

**Avokimi:** Shoqëria civile mund të avokojë për një integritet të përmirësuar politik—si në ligj ashtu edhe në praktikë. Në ambiente zgjedhore tejet konkurrense, ekzistojnë pak stimuj për partitë politike të veprojnë vullnetarisht me nivele të larta të integritetit, përveç nëse janë të detyruara me ligj që ta bëjnë këtë. Avokimi për politika të fuqishme, nga shoqëria civile, për financimin e partive politike dhe legjislacionin për shpenzime gjatë fushatave zgjedhore mund të nivelizojë pikënisjen dhe të kultivojë një kulturë të sjelljes etike.

Shoqëria civile mund të jetë e rëndësishme në ofrimin e hapësirave për dialog politik dhe bashkëpunim në procesin e vendimmarrjes dhe reformave. Për shembull, aktorët nga shoqëria civile kanë një rol vendimtar në mbrojtjen dhe mbështetjen e proceseve gjithëpërfshirëse politike. Deri sa shumë juridiksione fusin në kornizën ligjore përfshirjen në politikë, me kuota ose vende të rezervuara (veçanërisht për gratë dhe pakicat etnike ose fetare), organizatat e shoqërisë civile të cilat mund të kontribuojnë në rritjen e përfshirjes përmes aktiviteteve dhe avokimit. Në shumë vende, organizatat e shoqërisë civile shpesh janë pikat fillestare për gratë aktive në politike të cilat i bashkangjiten partive politike. Këto organizata mundën dhe duhet të jenë, avokatët më të fuqishëm për barazinë gjinore brenda të gjitha organeve partiake. Në mënyrë të ngjashme, organizatat që përfaqësojnë bashkësi historikisht të nënpërfaqësuar janë zëra efektiv për përfshirje të rritur.

## **Avokimi i shoqërisë civile në Meksikë**

Në Meksikë, një dispozitë, në kodin zgjedhor federal që përcakton 2% të fondeve federale të partive politike të shkojnë për trajnimin e udhëheqësisë së grave kryesisht u injorua nga ana e partive politike kryesore. Si përgjigje, aktivistët civilë dhe akademikët formuan një koalicion të gjerë me partitë politike dhe Institutin Kombëtar për Gratë (INMUJERES) për të avokuar zbatimin e duhur të dispozitës. Koalicioni, i quajtur “2% dhe më shumë gra në politikë”, zhvilloi një strategji mediatike, qarkulloi një peticion në internet dhe me sukses ndikoi komisionin zgjedhor për të kaluar reforma duke vendosur udhëzime të qarta për shpenzimet e trajnimit të partive dhe duke mandatuar shpалosjen e planeve të tyre për fuqizimin e grave politikane lidere. Zgjedhjet që pasuan panë një rritje historike prej 5.4% të grave në legjislaturën kombëtare, duke bërë që avokuesit dhe NDI të botojnë një udhëzues për mënyrën e organizimit të një fushate për avokim qytetar.<sup>28</sup>

GUÍA 2% Y + MUJERES EN POLÍTICA:

UNA EXPERIENCIA DE  
**INCIDENCIA**  
PARA COMPARTIR

**Monitorimi:** Në shumë vende, shoqëria civile monitoron proceset politike, duke luajtur rolin e “mbikëqyrësit” për t’i mbajtur partitë politike përgjegjëse për veprimet e tyre. Grupet për monitorim dhe vëzhgim të zgjedhjeve rregullisht raportojnë mbi proceset zgjedhore, duke përfshirë edhe aktivitetet e fushatave të partive politike. Organizatat që monitorojnë zgjedhjet kanë ekspertizë dhe njohuri të veçantë për rolet e partive politike në fushatat zgjedhore, veçanërisht në financimin dhe koston e politikës. Gazetarët hulumtues mund të kontribuojnë në proceset e vetingut dhe procesit të përzgjedhjes së kandidatëve duke publikuar informacione për përfaqësuesit e partive politike që kandidohen për poste.

Përcjellja e veprimeve qeveritare dhe atyre legjislative i mban përgjegjës udhëheqësit politikë dhe i lejon shoqërisë civile të edukojë qytetarët mbi ndikimin negativ të korrupsionit. Megjithatë, monitorimi i proceseve politike gjithashtu ju jep aktivistëve të shoqërisë civile një mundësi për të mbështetur përpjekjet e partive dhe institucioneve të tjera kur ata demonstrojnë një angazhim për ngritjen e integritetit. Publikimi i reformës së integritetit brenda partive politike do të kontribuojë në rritjen e besimit në sistemin demokratik.

## Monitorimi i shoqërisë civile në Ugandë

Në Ugandë, Aleanca për monitorimin e financave të fushatave zgjedhore (ACFIM) është një koalicion i aktivistëve të shoqërisë civile që bëjnë presion për transparencë në financimin e partive dhe fushatave zgjedhore. ACFIM operon kryesisht përmes monitorimit të korrupsionit

gjatë shpenzimeve të partive dhe shpenzimeve gjatë fushatave zgjedhore. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2016, ACFIM identifikoi raste të blerjes së votave nga kandidatët dhe zhvilloi një fushatë kundër kësaj praktike që rezultoi me 65% të fshatrave të synuara të miratojnë rezolutat kundër blerjes së votës. Në Kagoma, një peticion zgjedhor për blerjen e votave madje rezultoi në anulimin e rezultatit të zgjedhjeve të 2016 dhe organizimin e zgjedhjeve të reja. Duke monitoruar nga afër shpenzimet e partive dhe shpenzimet gjatë fushatave, ACFIM krijoi një mundësi për të çuar partitë drejt një integriteti më të mirë financiar.<sup>29</sup>



Sidoqoftë, ekzistojnë sfida për angazhimin e shoqërisë civile për të mbështetur integritetin e partive politike. Jo të gjitha sistemet politike favorizojnë angazhimin politik të shoqërisë civile. Shumë vende kufizojnë veprimtarinë politike të organizatave të shoqërisë civile me kontrolle ligjore ose masa ndëshkuese, duke e bërë avokimin, monitorimin ose bashkëpunimin të vështirë për aktorët civilë që dëshirojnë të promovojnë integritetin.

Për më tepër, ndonjëherë ekziston një konflikt në marrëdhëniet bashkëpunuese midis shoqërisë civile dhe partive politike. Në disa raste, organizatat e pavarura të shoqërisë civile mund të besojnë se me

mbështetjen e partive politike, madje edhe gjatë reformave të nevojshme të integritetit, rrezikojnë pavarësinë e tyre dhe kjo rezulton me dëmtimin e reputacionit të tyre. Në anën e kundërt, partitë në shumë vende shpesh herë kanë marrëdhënie të ngushta me organizata të ndërlidhura dhe dështojnë në arritjen deri tek aktorët civil të cilët mund të kontribuojnë me këshilla dhe ekspertiza të pavarura dhe kredibile.

## Monitorimi i mediave në Kosta Rika

Ashtu si shoqëria civile, organizatat e mediave luajnë një rol të madh në monitorimin e partive dhe për kërkimin e përgjegjësisë nga ata. Në Kosta Rika, gazeta La Nación publikoi



një seri raportesh që sollën deri në zgjedhjet e vitit 2014, të titulluara “#Novotoaciegas” (“Mos votoni verbërisht”). Gazetarët raportuan se të paktën 12 kandidatë të partive për legjisliv ishin përballur me hetime penale ose akuza gjatë fushatave të tyre. Raportet zbuluan dështimin e partive për të bërë veting të mirëfilltë të kandidatëve të tyre para zgjedhjeve. Përfundimisht, skandalet që rezultuan u bënë shkak për tërheqjen e së paku pesë kandidatëve për legjislativ në ciklet e mëvonshme zgjedhore. Duke monitoruar veprimet e partive politike, organizatat e mediave mund të mbajnë partitë përgjegjëse dhe të shpërblejnë progresin drejt integritetit.<sup>30</sup>

**Përfundimisht, bashkëpunimi në kërkimin e integritetit politik është një qëllim reciprokisht i dobishëm për partitë politike dhe shoqërinë civile.** Për partitë politike, organizatat e shoqërisë civile mund të ofrojnë ekspertizë sektoriale dhe mbështetje publike për nismat e reformës së integritetit. Për organizatat e shoqërisë civile, mbështetja e partive për të reformuar institucionet dhe praktikat e tyre plotëson qëllimet e tyre dhe prioritetet e tyre për qeverisjes së përmirësuar.

## Çështjet që duhet të konsiderohen për përmirësimin e integritetit të partive politike

### Struktura organizative dhe proceset e brendshme

Partitë politike janë mjete për shprehje politike që kërkojnë një rol në vendimmarjen publike. Si të tilla, ata kërkojnë strukturë, rend dhe rregullim të brendshëm për të siguruar se ata mund të kryejnë këtë funksion profesionalisht, efektivisht dhe etikisht.

Korniza rregullatore që e miratojnë partitë politike varet nga kërkesat ligjore vendore, realitetet gjeografike, origjina partiake e formimit, madhësia e saj, resurset dhe ambicjet dhe deri diku dhe ideologjia e saj. Kushtetutat, nënligjet, rregullimet, statutet, rregulloret dhe/ose deklaratat për vlerat

dhe vizionin janë të gjitha përdorura nga partitë për të përkufizuar qëllimet e tyre dhe se si do të sillen si organizata. Dokumentet të cilat rregullojnë strukturat dhe proceset organizative duhet të jenë udhëzues “të gjallë” për tu rishikuar dhe përditësuar me zhvillimin e vet partisë. Megjithëse partitë politike sjellin vendime për strukturën dhe organizim brenda partisë, partitë etike duhet të jenë transparente ndaj publikut për mënyrën e funksionimit të tyre.

### **Shoqëria civile dhe medat duhet të marrin parasysh:**

- Nëse partitë politike kanë statute dhe akte nënligjore të qarta dhe transparente?
- A ndjekin dhe a respektojnë partitë politike rregullat e tyre?
- A ka barazi gjinore në të gjitha organet vendimmarrëse të partive politike?
- A përfshijnë partitë politike anëtarë të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar në proceset e tyre të vendimmarrjes?
- A kanë partitë politike procese gjithëpërfshirëse dhe transparente për të zgjedhur udhëheqësit e tyre?

### **Kultura organizative**

Kultura e brendshme e çdo organizate është shtytësi kryesor i sjelljes së anëtarëve në të gjitha nivelet—nga zyrtarët më të lartë të partisë, deri tek votuesit dhe përkrahësit. Kultura e brendshme është mjedisi në të cilin anëtarët e partisë funksionojnë dhe gjithashtu përcakton vlerat dhe besimet e përgjithshme të një organizate ndaj opinionit të brendshëm dhe të jashtëm. Një përkufizim standard i kulturës organizative është “mënyra sesi i bëjmë gjërat këtu.”

Kultura e brendshme e një partie politike ndikon fuqishëm në suksesin apo dështimin e saj. Përjetimi i padrejtësisë, sjelljes abuzive, qëndrimeve egoiste ose hakmarrjes dhe ndëshkimit do të çojë çdo anëtar ose mbështetës të partisë të konkludojë se kultura e partisë jo vetëm që është jo mikpritëse, por dhe joetike, ndërsa zgjedhjet e tyre të sjelljes do të përputhen me këtë mjedis. Njëlloj, nëse një palë perceptohet se ka ndërtuar sistemet dhe praktikën e saja mbi besimin, drejtësinë dhe standardet etike që zbatohen mbi të gjithë në organizatë, partia ka më shumë të ngjarë të që do të kultivojë nivele më të larta të përkushtimit, inovacionit konstruktiv dhe besnikërisë brenda radhëve të saj.

### **Shoqëria civile dhe medat duhet të marrin parasysh:**

- A kanë partitë politike kode transparente të sjelljes dhe standarde për sjellje?
- A merren partitë politike në mënyrë etike me çështjet e ngacmimit seksual dhe dhunës?
- A kanë partitë politike politika antidiskriminuese dhe anti-ngacmuese për anëtarët e tyre?
- A angazhohen zyrtarët e lartë të partisë në veprime që konsiderohen të dobishme për partinë dhe jo për interesin e tyre vetanak?
- A sillen në mënyrë etike udhëheqësit e partive politike?

### **Vetingu i kandidatëve dhe përzgjedhja**

Partitë politike janë rojet e portës për atë se kush do të kandidohet për zyrë, kush do të flet në emër të partive dhe kush përfaqëson interesat e qytetarëve në organet legjislative. Sidoqoftë, në mbarë botën, votuesit kanë një marrëdhënie të pakëndshme me partitë politike dhe kandidatët, të cilët shpesh, zakonisht gjatë kohës së zgjedhjeve, japin premtime madhështore që votuesit i hedhin poshtë si jorealiste. Qytetarët gjithnjë e më shumë i perceptojnë partitë si klube të drejtuara nga elita me rregulla ndaluese të hyrjes dhe pjesëmarrjes; duke mos reaguuar ndaj qytetarisë më të gjerë; të

papërkushtuar ndaj transparencës dhe llogaridhënies; dhe jo të gatshëm për të përfshirë dhe fuqizuar gratë dhe bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar brenda strukturave të tyre. Për më tepër, çështjet e korrupsionit, mosndëshkimit dhe vetë-interesit dëmtojnë më tej besimin e publikut në partitë politike dhe kandidatët e tyre.

Një element kritik i rindërtimit të besimit në partitë politike përfshin forcimin e mekanizmave të brendshme për veting dhe për përzgjedhje të kandidatëve për të identifikuar dhe zgjedhur kandidatë me cilësi të lartë, të cilët mund bëjnë çmos për transparencë dhe integritet, dhe sinqerisht të përfaqësojnë qytetarët që ata kërkojnë t'u shërbejnë.

### **Shoqëria civile dhe medat duhet të marrin parasysh:**

- A bëjnë partitë politike veting të kandidatëve të mundshëm për konflikte të mundshme interesi, shkelje kriminale ose financiare dhe shprehje apo akte diskriminuese?
- A kanë partitë politike procese transparente për zgjedhjen e kandidatëve?
- A kanë partitë politike një numër të barabartë të grave dhe burrave si kandidatë në zgjedhje?
- A përfshijnë partitë politike anëtarë të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar si kandidatë në zgjedhje?

### **Diversiteti, barazia dhe përfshirja e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar**

Shumë parti zhvillojnë kultura të brendshme që dekurajojnë angazhimin nga aktivistë të rinj (siç janë gratë, gratë e reja dhe burrat e rinj, dhe bashkësi historikisht të nënpërfaqësuar) duke mbrojtur dhe duke u mbështetur në procedurat dhe praktikat e vjetruara dhe rritet e personalizuara të cilat shpesh pasqyrojnë normat gjinore mashkullore dhe të cilat hedhin poshtë idetë dhe inovacionet e reja. Kjo kulturë e brendshme e partisë parandalon promovimin e bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar, gjë që pengon larminë e mendimeve dhe përvojës. Përfshirja domethënëse jo vetëm që është një element thelbësor i proceseve demokratike, përfaqësimit dhe integritetit politik, por diversiteti i rritur gjithashtu kontribuon për parti të shëndetshme dhe më të suksesshme. Për më tepër, udhëheqja politike e grave siguron përparim në fushat e politikave që janë jetike për rritjen ekonomike dhe cilësinë e përmirësuar të jetës—mundësi që lihen pas, kur partitë politike nuk i japin përparësi roleve të vërteta të grave.

Të qenit përfshirës nuk do të thotë vetëm të sigurohet pjesëmarrja e barabartë e grave. Do të thotë gjithashtu të sigurohet përfshirja e bashkësive tjera historikisht të nënpërfaqësuar, si të rinjtë, pakicat etnike/fetare, bashkësia LGBTQI+ dhe personat me aftësi të kufizuara. Nëse partitë politike nuk pasqyrojnë elektoratin të cilin dëshirojnë ta tërheqin, atëherë atyre u mungon kredibiliteti për të folur dhe vepruar në emër të atij elektorati. Shoqëritë po bëhen gjithnjë e më të shumëllojshme, duke kërkuar nga partitë politike që të zhvillojnë politika të jashtme dhe të brendshme që pasqyrojnë shqetësimet e komuniteteve jo dominuese dhe të atyre historikisht të nënpërfaqësuar.

### **Shoqëria civile dhe medat duhet të marrin parasysh:**

- A ka një numër të barabartë të grave dhe burrave midis përfaqësuesve të partive politike?
- A janë partitë politike të përfaqësuara në mënyrë të barabartë nga gratë dhe burrat në ngjarje publike, përfshirë edhe intervistat në media, takimet publike, panelet në televizion dhe radio?
- A mbajnë partitë politike ngjarje publike që janë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara?
- A pasqyrojnë përfaqësuesit e partive politike përbërjen etnike, fetare dhe kulturore të këtij vendi?
- A mbështesin dhe a zbatojnë partitë politike politika antidiskriminuese, përfshirë këtu edhe të drejtat e përgjithshme për anëtarët e bashkësisë LGBTQI+?

### **Mbledhja e fondeve dhe menaxhimi financiar**

Këndvështrimet cinike të cilat shumë qytetarë i kanë ndaj partive politike, si subjekte të korruptuara, burojnë nga skandalet e pafund që lidhen me politikën dhe paratë. Asnjë çështje nuk shkakton më shumë vështirësi për partitë politike, si nga pikëpamja organizative, ashtu edhe nga ajo strategjike, dhe si një sfidë e menaxhimit të marrëdhënieve me publikun. Partitë politike kanë nevojë për burime për të garuar në zgjedhje, për të funksionuar si organizata ndërmjet zgjedhjeve dhe për të investuar në zhvillim, rritje dhe mësim. Por mënyra se si partitë mbledhin dhe përdorin resurset përcakton nëse ato kontribuojnë pozitivisht në qeverisje të mirë apo veprojnë nën ndikimin e agjendave të jashtme, madje edhe atyre të fshehura. Me pak fjalë, si (dhe nga kush) partitë grumbullojnë dhe shpenzojnë fonde, dhe sa transparente janë në lidhje me financimin, përcakton nivelin e tyre të integritetit—ose mungesën e tij.



Rregullimi i financave politike është një mënyrë për të garantuar nivelet themelore të pavarësisë, transparencës dhe barazisë brenda sistemit të qeverisjes. Sidoqoftë, këto sisteme kërkojnë kohë dhe kërkojnë që vullneti politik dhe udhëheqja të jenë efektive. Fatmirësisht, partitë politike nuk kanë nevojë të presin legjislacionin. Ekzistojnë praktika të brendshme që partitë mund t'i përvetësojnë, pa vonesë, për të nxitur marrëdhënie të ndershme me donatorët, financuesit dhe mbështetësit që manifestojnë nivelet më të larta të integritetit brenda dhe jashtë organizatës.

### **Shoqëria civile dhe medat duhet të marrin parasysh:**

- A ka vendi ynë legjislacion gjithëpërfshirës që rregullon financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore?
- A shpallin partitë politike rregullisht lista publike të plota të individëve dhe organizatave që dhurojnë fonde për ta?
- A japin rregullisht partitë politike deklarata gjithëpërfshirëse dhe të sakta të shpenzimeve?
- A përfshihen partitë politike në blerjen e votave gjatë zgjedhjeve?

## Mbështetja e sjelljes etike të partive politike

Shoqëria civile dhe mediat duhet të konsiderojnë mënyra për të mbështetur partitë politike të cilat janë përkushtuar që të përmirësojnë integritetin e tyre. Ka disa mënyra se si ata mund të punojnë me partitë në këtë proces, duke përfshirë:

	Avokimin për legjislacion i cili siguron transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe nga partitë politike, veçanërisht në çështjet e financimit të partive politike dhe fushatave.
	Të punohet me partitë për të rekomanduar gratë, aktivistët e rinj dhe aktivistët nga bashkësitë historikisht të nënpërfaqësuar që të përfshihen në poste dhe procese vendimmarrëse.
	Të bashkëpunohet me partitë politike për hartimin e politikave duke avokuar sigurimin e burimeve në lidhje me politikat që i përgjigjen nevojave dhe dëshirave të qytetarëve.
	Të organizohen biseda publike mbi çështjet e integritetit të cilat janë të rëndësishme për partitë politike.
	Të ftohen partitë politike dhe kandidatët e tyre të nënshkruajnë kode të sjelljes ose zotime për çështje që kanë të bëjnë me integritetin.
	Pajtim për përkrahje publike të partive politike dhe kandidatëve të cilët plotësojnë standardet specifike të integritetit.
	Në veçanti, mediat mund të insistojnë që partitë politike të përfaqësohen në mënyrë të barabartë nga gratë dhe burrat në panel diskutimet ose në intervista.
	Mediat mund të sigurojnë që ata të japin një mbulim të barabartë të kandidatëve gra dhe burra gjatë zgjedhjeve.

Përderisa shoqëria civile nuk mund të zëvendësojë partitë politike, aktivistët kanë rol që të mbajnë ato përgjegjëse dhe të mbështesin nisma që forcojnë proceset demokratike dhe politike. Të kuptuarit e sfidave për integritetin e partive politike dhe bashkëpunimi në sferat e interesit të ndërsjellë mund të kontribuojnë në rritjen e sjelljes etike të përfaqësuesve të qytetarëve.



## ENDNOTES

- 1 Nagele-Piazza, Lisa (2018). *Bullizmi dhe ngacmimi në vendin e punës: Çfarë është dallimi?* SHRM. <https://bit.ly/3fhXlrF>
- 2 Citizens Advice (Këshilla për qytetarët) (2020). Ngacmimi: <https://bit.ly/30cv9ph>
- 3 FindLaw (2019). Çfarë është diskriminimi? <https://bit.ly/2ZWluTv>
- 4 Në zhvillimin ndërkombëtar, "rinia" përcaktohet ndryshe duke u bazuar në llojin e ndihmës për zhvillim dhe kontekstin sociokulturor ku ofrohet. Përkufizimet e rinisë varen nga perceptimi se kur dikush shihet si i rritur dhe i pavarur nga familja, i cili mund të ndryshojë ndjeshëm nga konteksti. NDI përgjithësisht punon me gra dhe burra të rinj midis moshave 18-30 vjeç, por e përshtat këtë gamë për t'iu përshtatur konteksteve të ndryshme të vendeve. <https://youthguide.ndi.org/context-youth-development-and-political-participation#defining-youth>
- 5 Anketa të shumta në rajonet e botës konfirmojnë këtë trend, duke përfshirë këtu edhe demokracitë e vjetra. Shih për shembull, Stoker, *Trust and Democracy in Australia (Besimi dhe demokracia në Australi)* (2018); *Eurobarometer* (Vjeshta 2017); dhe *Afrobarometer* (2014/15).
- 6 Wardle, Pete (2017). *Cost of Politics* (Kostoja e politikës). Westminster Foundation for Democracy. <https://bit.ly/2ZeDOYK>
- 7 Shih Jamille Bigio dhe Rachel Vogelstein, "*Women Under Attack (Gratë nën sulm): The Backlash Against Female Politicians (Reagimi kundër politikaneve)*," *Foreign Affairs*, (janar /shkurt 2020), *Linkages between political parties and political violence – ACCORD (Lidhjet midis artive politike dhe dhunës politike)*. John Rabuogi Ahere (2018), *Democracies Divided (Demokracitë e ndara): The Global Challenge of Political Polarization (Sfida globale e polarizimit politik)*, Thomas Carothers and Andrew O'Donohue (2019).
- 8 Komisioni i Venedikut (2010). *GUIDELINES ON POLITICAL PARTY REGULATION BY OSCE/ODIHR AND VENICE COMMISSION Adopted by the Venice Commission at its 84th Plena*, fq 13.
- 9 Liddiard, Patrick (2019). *What Can Be Done About the Problem of Political Parties*. (Çfarë mund të bëhet lidhur me problemin e partive politike). The Wilson Center. <https://bit.ly/304eAvE>
- 10 Instituti nacional demokratik (2011) *A Compilation of Political Party Statutes*. (Kompilim i statuteve të partive politike) <https://bit.ly/2W46Yrt>
- 11 Moxey, Paul (2016). *Incentivizing Ethics (Nxitje e etikës): Managing Incentives to Encourage Good and Deter Bad Behaviour (Menaxhimi i stimujve për inkurajim të sjelljes së mirë dhe për largim të sjelljes së keqe)*. Transparency International UK, fq. 14. <https://bit.ly/2DpdHpy>
- 12 Examples from the private sector include *Organizational Culture Drives Ethical Behaviour (Shembuj nga sektori privat përfshijnë Kultura organizative drejton sjelljen etike): Evidence From Pilot Studies (Dëshmi nga pilot studime)*, nga Forumi global i OECD 2018, *Kundër korrupsionit dhe për integritet*, <https://bit.ly/2ZeqbsC>; dhe *Nxitje e etikës e Transparency International: Managing Incentives to Encourage Good and Deter Bad Behaviour (2016) (Menaxhimi i stimujve për inkurajim të sjelljes së mirë dhe për largim të sjelljes së keqe)*, <https://bit.ly/2DpdHpy>
- 13 Filabi, Azish & Bulgarella, Caterina (2018). *Organizational Culture Drives Ethical Behaviour (Kultura organizative drejton sjelljen etike): Dëshmi nga pilot studime*. Forumi global i OECD 2018, *kundër korrupsionit dhe për integritetin*, fq. 2. <https://bit.ly/2ZeqbsC>
- 14 Ilib.
- 15 Ilib.
- 16 Casas, Kevin & Quesada, Tomàs (2019). *Legislative Candidate Vetting Mechanisms in Latin American Political Parties*. NDI Instituti nacional demokratik <https://bit.ly/38J2Hik>
- 17 Ibid.
- 18 Shih *Legislative Candidate Vetting Mechanisms in Latin American Political Parties* (Mekanizmat legjislativë për veting të kandidatëve në partitë politike të Amerikës Latine) për më shumë lidhur me arsyen se përse këto mekanizma janë vitale për partitë që janë të përkushtuar integritetit.
- 19 Kush përbën një grup të nënpërfaqësuar ndryshon midis bashkësive dhe konteksteve. Anëtarë të bashkësive historikisht të nënpërfaqësuar mund të përfshijnë—por jo edhe të kufizohen vetëm në—gratë, pakicat etnike, fetare dhe të dukshme, anëtarë të bashkësisë LGBTQI+, persona që jetojnë me aftësi të kufizuara dhe rinia.
- 20 Bauhr, Monika; Charron, Nicholas; Wängnerud, Lena (2018). *Exclusion or interests? (Përjashtim apo interese? Why females in elected office reduce petty and grand corruption. (Përse femrat e zgjedhura në detyrë zvogëlojnë korrupsionin e vogël dhe të madh)*. *European Journal of Political Research*. <https://bit.ly/3fvmuER>
- 21 Kjo gazetë kanadeze tregon se gratë në qeveri mund të sjellin ndryshimet e dëshiruara në shendetin publik: <https://bit.ly/2W7pUpu>
- 22 Werber, Cassie (2015). *Forcing Spanish political parties to nominate more women is helping them win votes*. Quartz. <https://bit.ly/3gQZJuX>
- 23 Shih *Women's Mobilization and Transformation in South Africa's ANC* (p. 101-104).
- 24 *A Compilation of political party statutes (Një kompilim i statuteve të partive politike)*, Instituti nacional demokratik
- 25 Asia-Europe Foundation, Hanns Seidel Foundation, & The International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2014). *Political Parties and Citizen Movements in Asia and Europe (Partitë politike dhe lëvizjet e qytetarëve në Azi dhe Evropë)*. <https://bit.ly/38L99FD>
- 26 *Transparency International España* (2014). *Transparency International dhe PSOE nënshkruajnë marrëveshje për transparencë dhe kundër korrupsionit*. <https://bit.ly/2BPgBDR>
- 27 Kukutschka, Roberto Martínez B.; Valladares, Jorge; Vrush, Jon (2020). *Building Political Integrity to Stamp Out Corruption: Three Steps to Cleaner Politics*. Transparency International. <https://bit.ly/38I2KLx>
- 28 Instituti nacional demokratik (2013) *Mexican Women's Coalition Pushes for Reform, Creates "Toolkit" for Advocacy*. <https://bit.ly/2DvPZYU>
- 29 Instituti nacional demokratik (2020) *Promoting More Policy-Focused Political Parties*. <https://bit.ly/2CkTot4>
- 30 Casas & Quesada. *Vetingu legjislativ i kandidatëve*.





The background is a vibrant blue gradient with a pattern of radiating lines that create a sense of depth and movement. Scattered throughout are various geometric shapes: five-pointed stars of different sizes and solid circles, some appearing as if they are floating or falling. The overall effect is dynamic and celebratory.

**INSTITUTO NACIONAL DEMÓCRATA**  
**ndi.org**